



**NJERIU  
MPOSHT  
NAT YRËN**

BIBLIOTEKA

854-32  
Nj 55

844-32

Nj. 55.

N J E R I U  
M P O S H T  
N A T Y R Ë N

~~40465~~

(Përshkrime, reportazhe)

INTER 29.12



**TU QEPEMI KODRAVE E MALEVE, TI ZBUKUROJMË  
E TI BËJMË ATO PJELLORE  
SI EDHE FUSHAT**

**ENVER HOXHA**

## HYRJE

Në këtë vëllim që u jepet në dorë lexuesve, janë përbledhur një numër shkrimesh marrë nga shtypi, ku spikat në mënyrë të veçantë vrulli revolucionar dhe mendimi krijues që ka përfshirë punonjësit e bujqësisë pas botimit të Thirrjes së KQ të Partisë e Këshillit të Ministrave dhe Letrës së hapur të KQ të PPSH. Thirrja dhe Letra e hapur ngjallën një optimizëm të madh dhe një besim të patundur te punonjësit e bujqësisë për ndërtimin e socializmit, duke u mbështetur në forcat tona, për prodhimin dhe sigurimin e bukës nga çdo ekonomi bujqësore me vetë forcat e saj. Këto parulla revolucionare janë bërë një realitet i mrekullueshëm dhe një nxitje e madhe për të marshuar gjithmonë përrapa.

Shkrimet e ndryshme që janë përfshirë në këtë vëllim, tregojnë se mendimi krijues dhe entuziazmi i masave përbysën paragjykimet, planet e hartuara pa marrë parasysh vrullin e tyre revolucionar, mposhtën subjektivizmin dhe konservatorizmin, hodhën poshtë me përbuzje prirjen për të marrë sa më shumë nga shteti, u ngritën kundër rehatllékut mikroborgjez e kundër interesit vetiak. Ato tregojnë se, kur kooperativistët vunë politikën në plan të parë, ata u bënë më të ndërgjegjshëm në të kuptuarit e detyrate dhe në zbatimin e tyre.

Në shkrimet e tjera, lexonjësi do të gjejë shembuj të lartë frysëzimi, shembuj që tregojnë frutet e mendimit dhe të vrullit revolucionar në një kooperativë malore, që duke u mbështetur fort në këmbët e veta, u mat si një gjigand me malin dhe e mposhti atë. Kjo është kooperativa malore e Vritshit, ku ka gjetur shprehjen më të plotë patriotizmi i flaktë, frysma e lartë revolucionare, qartësia politike, ndërgjegja e mrekullueshme në punë, vendosmëria dhe vetmohimi për të bërë realitet mësimet e partisë. «Ky është Taxhai shqiptar» u shprehën disa miq kinezë që vizituau vendin tonë pak kohë më parë. Por shembulli i Vritshit nuk është i vetëm.

Në këtë përbledhje, megjithëse disa nga shkrimet janë shkruar thjesht, pa zbulime dhe mjete letrare, bien në sy shumë shembuj të mrekullueshëm, që tregojnë përpjekjet heroike të njërrëzve tanë për të mposhtur natyrën, për t'i rrëmbyer shkëmbit bukën, për të prutë ujët nga bjeshkët, që të vaditin tokat në çastet, kur bimët varin kokën të etura për një pikë ujë përpjekjet e mbinatyrëshme të njërrëzve tanë që shkojnë me orë të tëra larg për të marrë një thes me pleh që të plehërojnë tokat e varfëruara. Shumë nga këto shkrime të emocionojnë e të frysëzojnë për vetmohimin e lartë që po tregojnë punonjësit tanë të bujqësisë në të katër anët e atdheut. Por reportazhet dhe përshkrimet, sidoqë prekin probleme dhe çështje të ndryshme, ato kanë edhe një anë të përbashkët, qëllimin e madh që i kanë vënë vetes shumë ekonomi bujqësore për të siguruuar bukën me forcat e tyre, të ndërgjegjshëm se kështu luftojnë dhe veprojnë si revolucionarë.

Shkrimet e ndryshme që botahen në këtë përmbledhje, na jepin një tablo të plotë të punës entuziaste dhe plot vëtmohim që bëhet sot në fshatin tonë të ri socialist.

## BISEDA PËR BUKËN...<sup>(1)</sup>

...Puna ime e tanishme, si korespondent i posaçëm i gazetës letrare, më ka bërë që të jem shpesh në rrugë. Udhëtimi është një gjë e këndëshme. Shinan e trenit, boria e lokomotivës, asfalti i zi i xadesë, njerëz që i shikon aty-këtu vetëm për një minutë. Peizazhet shkrihen njëri pas tjetrit, si në montimin e një filmi. Por, mbi të gjitha, janë interesantë njerëzit. Njerëzit dhe bisedat e tyre.

Në rrugë, në vendin e autobuzit apo në kupe-në e trenit, njerëzit miqësohen shpejt dhe flasin për gjithfarë gjérash. Më kujtohen shpesh shumë gjëra që kam dëgjuar rrugëve. Por, mbi të gjitha, më ka mbetur në mendje biseda për bukën. Biseda për bukën është motiv i madh i të gjitha njohjeve, i të gjithë udhëtarëve, i të gjitha stacioneve, agjensive dhe vendqëndrimeve.

- Moti po na mban mirë...
- Po. Gruri u bë qamet...
- Shiu që ra para dy javësh, i bëri mirë tokës...
- Qe shi i shtruar, i butë...
- Në anët tonë edhe misri është bërë goxha...
- Edhe dy javë po mbajti koha kështu, do të jetë një mrekulli për bujqësinë...
- Sidoqoftë, pas nja dhjetë ditësh, do të duhej një shi...
- Ajo do të ishte ideale fare...

— Vështroni ato taraca, vështroni!...

Kush nuk i ka dëgjuar këto fraza të shkëmbryera midis njerëzve që ende nuk janë njojur mirë, midis fshatarëve me xhoke dhe nëpunësve që shkojnë me shërbim, midis konduktoreve dhe gazetarëve, midis ndonjë vajze dhe ndonjë ushtari që kthehet me lejë.

Biseda për bukën. Biseda e madhe kombëtare. Ajo është preludi i bisedave të tjera, për çështjet më të ndryshme, duke filluar nga probleme të fëmijëve, gjer te shkëmbimi i mendimeve për ndonjë film që lojti javën e kaluar. Ajo qëndron përpëra të tjerave, ashtu si buka në tryezën e të ngrënët.

Dhe kjo nuk ndodh për arësyen e thjeshtë se nga të dy anët e rrugës, apo trasesë mbi të cilën ti udhëton, zverdhojnë e gjelbërojnë njëra pas tjetrës ara me grurë e me misër, që duket sikur me mijra kallinj ta bëjnë me dorë e të thonë: «Ne jemi këtu, flisni për ne». Jo. Kjo nuk është një gjë kaq e rastit. Shkaku është më i thellë. Problemi i bukës është për ne problem kombëtar. Ai lidhet drejtpërdrejt me socializmin, pavarësinë, me çdo gjë të bukur që kemi krijuar e po krijojmë. Ai lidhet me shtëpitë tona, me këngët tona, me gjithçka. Ne ende dëgjojmë se si betohen nganjëherë prindët tanë me fjalët «për atë bukë».

### ... Taracat

Vendi ynë është i vogël. Kjo është një nga gjerat e para që mësojmë në gjeografi. Ndjenjën e pezmatimit të fëmijëve, kur marrin vesh se sa pak vend zë Shqipëria në globin tokësor, e kemi provu-

ar pothuaj të gjithë. Por, siç ka thënë një i vjetër: «Atdheun e duam jo se është i madh, por sepse është yni». Veç kësaj, siç kanë thënë poetët, atdheu nuk matet me hektarë, ai matet me përpjekjet e popullit, me heroizmat e tij, me gjakun e derdhur.

Por le të kthehem te gjografia. Njëzet e tetë mijë kilometra katorë. Megjithatë nuk janë aq pak. Nuk janë aq pak sidomos po të kemi parasysh që toka jonë, si tokë e lashtë, është shumë e rrudhur dhe, duke qenë e rrudhur, ajo ka, në realitet, një sipërfaqe më të madhe.

Hapja e tokave të reja dhe krijimi i taracave në vendet malore është një nga gjërat më të mrekullueshme që po bëjnë sot njerëzit tanë. Duke hapur toka të reja dhe duke krijuar taraca, ne praktikisht e zgjerojmë sipërfaqen e atdheut tonë. A ka gjë më të bukur e madhështore se sa të zgjerosh sipërfaqen e vendit tënd në këtë mënyrë? Udhëton dhe zemra të bëhet mal, kur shikon faqen e malit të dhëmbëzuar, kur shikon se si vendet djerr e të shkreta dëbohen vazhdimisht në thellësira. S'ka gjë më të shëmtuar se tokat shterpa. Këtë vit u bë një punë e madhe heroike. Por duhet bërë më shumë. Duhet t'i shkëputim sa më shumë teren shterpësisë. Duhen sulmuar djerrinat dhe pjerrësirat edhe në thellësitë ku janë struktur, në mënyrë që ato të mos e ndjejnë kurrë veten të qetë dhe të dorëzohen. Sepse ka ende shumë rezerva, sepse sipërfaqja e atdheut mund të shtrihet e të zgjerohet ende.

Të rinosh atdheun, t'i heqësh rrudhat, kjo nuk është një gjë e thjeshtë. Nuk është si puna e fytyrës së një dame të vjetër që mund të rregullohet me një operacion plastik. Këtu duhen forca shumë të mëdha,

plugje, kuaj, traktorë, por, në radhë të parë, heroizëm.

Populli ynë e ka dashur dhe e ka çmuar tokën e pakët që ka patur. «Duhet mbathur toka», — thotë fshatari, sikur të fliste për fëmijët e tij, që zakonisht i linte të bridhnin zbathur «Ara buzë lumit, si fëmija i vetëm» — vazhdon të thotë populli, sepse populli e dinte se ç'murtajë e keqe ishin erozionet për tokën. Ujrat e pasistemuara, që fryhe-shin e lëshoheshin si bishat tatëpjetë, kafshonin e shkatërronin ku të mundnin baltën e butë të fushave. Dhe kështu trualli i vogël i atdheut mbildhej e bëhej edhe më i vogël. Por kjo histori e trishtuar i përket tani së shkuarës.

Tokat e reja! I shoh si hapen para meje nga të dy anët e rrugës me ngjyrën e tyre karakteristike kafe ose të zezë. Çdo gjë e re është e bukur. Rinia e këtyre tokave shkëlqen me tërë mrekullinë e saj. Ato quhen toka «të reja». Kjo do të thotë se është hëra e parë që ato punohen, se është hera e parë që mbillen. Për ato ka filluar një epokë e re. Ato hynë, si të thuash, në jetë. Këtej e tutje, ato do të prodhojnë bukë për njerëzit, ashtu si motrat e tyre të vjetra, tokat fushore, të cilat kanë shekuj që janë pnuar nga parnenda e lashtë.

Tani kudo nëpër Shqipëri, që nga veriu në jugë, të dalin përparrë, të shtrira në faqe të pjerrëta malesh dhe bregresh, tokat dhe taracat e reja. Kalimtari që kalon përbri, vështron i gëzuar dhe thellë nga zemra u uron prodhime të shumta drithrash tokave të reja, tokave nuse.

#### ISMAIL KADARE

1) Fragmente të shkëputurë nga «Motive Nëndori»  
(*«Zëri i Popullit»*, shtator 1966).

## NË RRËZËT E IVANIT

Matanë malit të Ivanit, tutje vargmalit me gurë e shkurre, shtrihet një zonë, e cila, megjithse i përket Devollit, është si e mënjanuar prej tij. Për të hyrë në Devoll, kalohet nëpër grykën e Cangonjit e, apo del në tokat e Progërit, duket e gjithë ajo trevë me fushën e kodrinat e veta, kurse për të shkuar në Shuec e Rakickë, duhet të kalosh nëpër grykën e Trenit, të lesh më të djathtë ligenin e Prespës së Vogël dhe të marrësh përpjetë.

Kisha njëzet e ca vjet pa shkuar këtyre anëve. Nëpër malet me bushkat e shkurtra kisha qënë ditë e javë me radhë, kurse, nëpër katundet, isha futur vetëm natën. Një herë kisha ngjitur në errësirë të përpjetën thikë të Progërit, në errësirë kisha kalluar anës ligenit dhe po natën kisha hyra në Rakickë... Në mëngjes dola nga Rakicka dhe vetëm në ato pak minuta munda ta vështroj fshatin në drithën e diellit. Ishte një fshat i mjerë, me dritare të maskuara si me kafazë, me rrugë pa rrugë, me një çezmë të vetme, në të cilën mund ta shkonje duke zbritur disa shkallina, sikur zbrisnje në një katkombë. Shkollë nuk kishte fare, e, si dukej, e vetmja ndërtesë publike ishte xhamija. Nëpër muret e shtëpive mbanin varur vargje me duhan e me pipere të kuqe, kurse disa ballkone shtëpish ishin të mbuluara me rrogoza. Kujtoj fare mirë se asaj kohe, qoftë ditën, qoftë natën, vajzave, grave apo

nuseve u ishte e ndaluar të delnin nga pragu i portës e as mund t'i vështronte kushdo që u hynte në shtëpi.

Tashqi nuk pashë më kafazë nepër dritaret, as rrogoza nepër ballkonet, rrugët i gjeta të shtruara me gurë dhe atë çezmën e vjetër si katakombë e gjeta të rilindur, rrrethuar me mure guri e cimento. me postafë të mëdhenj e të gjérë. Nuk di përsë tashqi, majë e minaresë ishte shëmbur kurse pak më këtej, para një godine të madhe, losnin e kërcenin nxënësit e shkollës shtatëvjeçare.

Jeta e re e këtyre katundeve filloj pas çlirimt. Të dy katundet janë mbledhur në një ekonomi të vetme dhe suksesi i parë i tyre ka qenë sa i madh aq edhe i pabesueshëm. Toka e varfër, malore, plot gurë e haliça, kurrë ndonjëherë nuk i kishte ngopur me bukë banorët e këtyre dy katundeve. Ajo që e dërmonte bujqësinë këtej ishte mungesa e ujrale. Përveç një çezme të vetme në Rakickë, këtyre anëve nuk mund të gjesh burim uji. Plajave shkëmbore të çveshura mërzejnë gjarpërinj e nepërka, retë e shiut rrallë herë duken këtej, gjë e gjallë zbret orë të tëra udhë për të pirë ujë. Një zonë e vështirë si për bujqësinë ashtu edhe për blegtorianë. Por banorët e këtyre anëve më në fund e gjetën rrugën e tyre. Vendosnë që të luftojnë me këmbëngulje, vendosnë të përbysin mënyrat e vjetra të punës, vendosnë që ta bëjnë natën ditë dhe ta prodhojnë vetë bukën e tyre. «Mjaft më i ramë më qafë shtetit. Me forcat tona do ta sigurojmë bukën me cdo kusht». Ky mendim zuri rrënëjë të thella në ndërgjegjen e çdo kooperativisti.

Duke i treguar këto, sekretari i organizatës bazë qëndron dhe më rrëfen mbanë rrugës një min-

jollë dushku. Nëpër lëkurën e njomë të drurit shihen shenjat e ndonjë bremjeje.

— U japim deleve bërsi panxhari, por bërsija i bën të kërkojnë ujë, ujë s'ka dhe kafshët gërzitin lëkurën e njomë të drurit.

Në vitin 1961 kooperativa e bashkuar e Rakicës, arriti më në fund ta prodhojë vetë bukën e saj. Kryetari i saj, Gurja, më shpjegon:

— Më përpara, mjaft nga ne punonin me shata që i kishin bishtat të gjatë. Duke punuar fushës kështu, dukeshin jo si bujq, por si fodullë. Menduan dhe e gjetmë të udhës që shatave t'ua shkurtojmë ca bishtat. Kështu vepruam, se devollinjtë e fushës thonë një fjalë: «Toka nuk do që t'i rrish përsipër si fodull, toka do që ta ulësh kurrizin, le të të dhëmbë ca beli, se shpërblimin e merr në fund».

Por kooperativistët nuk u kënaqën me përfundimet e vitiit 1961. Ata vijuan të punojnë me krahe dhe me mënd. Shtuan gjënë e gjallë, kërkuan traktorë nga SMT-ja, u vunë veshin këshillave të agronomëve, dërguan Syrja Dikon të mësojë përagronom dhe, në vitin 1964, patën teprica të tillë sa i dhanë shtetit 1200 kuintalë bereqet.

Natyrisht, një sukses i tillë është tepër i madh dhe gati i pabesueshëm, por nëqoftëse del arave të Rakickës dhe vështron sesi punojnë njerëzit, atëherë bindesh se puna bën çudira.

Shkova në një parcelë ku mbilleshin patatet. Nga larg më dukej sikur mbillnin misër, sepse shihja vajzat që u shkonin prapa pendarëve dhe diç numëronin përmbi brazdët. Kur u afrova, pashë një mënyrë pune që nuk e kisha vënë re gjetiu. Pendari kalonte, pas tij vinte vajza me një shportë

në duar. Ajo hidhte farën dhe pas saj vînin tri, kâtër vajza me disa farë targaçikësh në krah. Ato lëshonin pas brazdës pleh të dorës së parë. Toka ishte e punuar kushedi sa herë, ishte gjithë vlagë, e shkrifur dhe e butë si për të mbjellë borzilok.

Këtu unë vështrova vetëm pendarët, qetë e punës dhe brazdat e gjata. Vajzat ishin me kapele kashte të mëdha mbi kokë. Nuk mund t'i shihja, megjithse ato flisnin, qeshnin, bënin shakara.

...Për vaditjen e tokave, vëndësit e këtyre katundeve, më përpara (sikurse tregojnë) shihnin vetëm qiellin. Gjithshka «varej te reja». Edhe çezma e vetme, që ndodhet në mes të fshatit, gjendet thellë, disa hapa nën sipërfaqen e tokës dhe përvaditje as që mund të mendohej. Rakicka me gjithë tokat e saj më të mira, është si një gropë. Nuk ka asnjë përrua ku ujrat e shirave të rrjedhin tatëpjetë. Në një rast të tillë, Rakicka mund të kthehej lehtë në një liqen apo në një kënetë. Por me sa duket, toka ka aty këtu gjeratore dhe kërteçina që përpjnjë ujrat dhe i çojnë poshtë në Prespën e Vogël. Njerëzit i mënjanuan gjeratoret, ngritën mure e diga të vogla dhe ndërtuan kështu, ndënë Rakickë, një rezervuar uji për vaditje. Dhe për herë të parë në historinë e këtyre katundeve filloj ajo që nuk praktikohej kurrë: vaditja artificiale. Natyrish, nga një shtërgjesë e tillë përmungesën e ujrave, këtu s'mund të mendohej për ndonjë hidrocentral të vogël. Por për dëshirën dhe gjëzimin e kooperativistëve, është ngritur këtu një central i vogël elektrik që punon me karburant.

Në katundin Shuec, që është sektor i kooperativës, kaluem kur pendarët mbillnin misër në tokat afër fshatit. Ishin ditët kur mollët sa po kishin lulëzuar dhe katundi i vogël dukej i kredhur i tëri nën bardhësinë e luleve. Një kontrast të fortë bënte liqeni me ngjyrat e kaltra të ujrave dhe të gjelbra të shavarit, tutje ngrihej mali shkëmbor i Trenit, gri dhe si i plumbtë. Anës liqenit gjetëm djem të vegjël që peshkonin me grepa, nëpër ujrat kalonin varka të vogla peshkimi, pastaj disa kalibe kashte të një ndërtimi krejt original. Por këtu dëgjuam për një parcelë një emërtim pak të çuditshëm. Një parcelë jonxhe përmbi fshat e thërrisin: parcela e Kinostudios. Kishte një histori interesante ajo jonxhë. Më përpara pat qënë një farë meraje. Fshati ishte ndarë më dysh. Disa donin ta hapnin si tokë të re, disa të tjerë, duke vënë shkak se duhej për kullotë, nuk donin. Fjala fjalës dhe kishin patur sher. Pra ishte mbledhur katundi te shkolla dhe jepnin e merrnin seicili në mendimin dhe arësyetimin e vet. Por, nëse midis burrave kishte mos-marrëveshje, rinia e fshatit ishte krejt në anën tjetër. Të rintjtë dhe të rejat nuk merrnin fare pjesë në mbledhje. Ata kishin marrë kazmat në duar dhe po bisedonin përjashta mureve të shkollës. Dhe së të mbaroheshin «arësyetimet» brenda në sallën e shkollës, rinia kishte marrë vendimin: Ta çelim meranë!

Dhe kështu kishte ndodhur me të vërtetë. Ndërsa brenda në shkollë kuvëndohej, rinia që vërsulur përmbi meranë me tokë tul dhe plisat ktheheshin përbys.

Dhe ajo tokë virgjër, e papunuar kurrë, kishte rritur tashti një jonxhë që s'mund t'ia gjesh shqen në gjithë Devollin.

Në mes të katundit Rakickë, që nga koha e parë mbaja mend një baltinë ku zhgryheshin gomarët dhe buajtë. Tashti baltina ishte tharë, po përsëri kishte ngelur djerrë.

Unë u ndodha në Rakickë në majin e kaluar, në kohën kur shokët e Kinostudios vijonin të xhironin një film dokumentar. Njërit prej shokëve i shkrepit diçka në kokë. E dëgjova tek i thoshte Gures.

— Shoku kryetar, unë bisedova me rininë e fshatit pér çështjen e kësaj baltine. Këtu bëhet një park i bukur, që do ta hijeshojë fshatin, pse ta lemë kështu?

Të nesërmen në mëngjes u fillua nga puna. U mblodh gjithë fshati, erdhën edhe gjithë nxënësit e shkollës me gjithë pedagogët. Një automjet nisi të sjellë gurë, muratorët ia filluan punës...

Mirëpo ndërhyri një nga fshati me një arsytim të goditur:

— Dëgjomëni mua, kjo tokë është plehë e tëra, ta mbjellim me patate... e di si bëhen patatet këtu? Tamam si popla, ve bast unë, po nuk muarmë këtu pesëdhjetë kuintalë patate...

Dhe kështu u vendos. Toka do të mbillej me patate sivjet, kurse pér vitin e ardhëshëm... «do shohim e do bëjmë».

\* \* \*

Salla ishte mbushur plot e përplot. Kishin ardhur edhe të rinj e të reja nga Shueci.

Sapo mbaroi takimi letrar, rinia e ktheu mbrëmjen në vallzim.

Vallzim në Rakickë! Mua që kam qënë këtu njëzet e ca vjet më parë, më duket diçka e cuditëshme! E pyes Guren si ja çon me rininë. Ai është më se i kënaqur prej punës së tyre.

U largova nga Rakicka me një bindje të thellë te e ardhmja më e gëzuar dhe më e begatëshme e këtyre katundeve.

Ata që dikur nuk ngopeshin kurrë me bukë, ata që prisin t'u japë toka atë që mund t'u jepte dhe që tani u jep atë, që sipas mendimit të tyre është e «detyruar» ta japë, i janë përveshur punës për t'i përtërirë tokat, tamam siç janë përtëritur edhe vetë. Ata janë bërë zotër të tokës së tyre dhe të fatit të tyre.

#### SOTIR ANDONI

(Nëndori Nr. 7, korrik 1966)

## FRUTET E MENDIMIT DHE TË VRULLIT REVOLUCIONAR

Kur lë Përroin e Thatë dhe i ngjitesh malit shkëmbor Vuç Kurtej, mendon për një çast se ndoshta lart, në shpatullat e Veleçikut, ku gjendet kooperativa e Vrithit, do të ketë ndonjë pllajë të vogël. Ndryshe, si është e mundur që në mal të merren 25 dhe 30 kv. misër për hektar, pa patur asnjë parcelë nën ujë?

Vështirë të gjendet një kooperativë tjetër ku të ketë kaq shumë gurë, kaq shumë mure për të mbajtur dheun e atyre ngastrave të vogla që ngjajnë si oaze në këtë teren malor.

Shtëpitë e reja të fshatit, taracat me mure, që ngjajnë si shkallë të një forme amfiteatri dhëntë që blegërinë, malet e larta — të gjitha këto së bashku përbëjnë një tablo të goditur të një fshati malor. Vettëm njerëz nuk shikon në kohën e punës. Të duket për një çast 'se e kanë braktisur fshatin. Por jo. Vrithiotët janë të lidhur me punën, me truallin e stërgjyshërve; aq më tepër tanë që as u shkon ndër mend të largohen prej këtej. Jetojnë mirë në shtëpi të reja, me të ardhura të mira. Një jetë krejt e ndryshme nga ajo që kanë bërë dikur, qoftë edhe gjashtë-shtatë vjet përpara.

Nga i kanë siguruar këto të ardhura që e ndryshuan mënyrën e jetesës? Përgjigja e kësaj pyetjeje është vështirë të jepet me dy fjalë. Ky është, ndoshta, kapitulli më interesant për këtë kooperativë,

e cila mund të vlejë jo vetëm si shembull, por edhe si flamurtare për kooperativat tona malore.

Shtatë vjet më parë, kur u krijua kooperativa bujqësore e Vrithit, të gjitha tokat që bashkuan anëtarët e saj nuk i kalonin të 30 hektarët. Me këtë sipërfaqe vështirë të plotësoheshin nevojat për bukë, e aq më tepër të siguroheshin të ardhura të mira. Atëherë çfarë duhej bërë? Të trokitej vazhdimi shëtëzuar në zyrat e pushtetit, në bankë dhe në depot e shtetit? Kjo nuk ishte rrugë e drejtë. Duheshin gjetur, pra, rrugë të tjera për të forcuar kooperativën, të çeleshin toka të reja, të sigurohej më shumë pleh, të mos mbillej vetëm misër, por edhe patate, thekér, jonxhë, fasule, lakér, pemë frutore. Nga të gjitha këto detyra që i caktuan vetes, më e vështira ishte çelja e tokave të reja. Duheshin hequr shkëmbinjtë, duhej pastruar toka nga gurët. Por të gjitha vështirësitë u muarën parasysh. Një grup familjesh, një grup njerëzish atje lart, në mësimin e Shkodrës, i vunë shpatullat punës dhe për çdo vit zgjeruan sipërfaqen nën kulturë. Gjatë pësë vjetëve të parë ata arriten ta dyfishojnë tokën e punueshme dhe të shtojnë rendimentet. Kështu plotësuani nevojat për bukë me prodhimet e veta, shtuan edhe të ardhurat, duke sigruuar mesatarisht 15 lekë, dhe, ndonjë vit, edhe 20 lekë të rinj përditëpune.

Kultura kryesore për ta ka qenë misri. Më vonë u shtuan edhe patatja, thekra, jonxha, fasulja, lakra, etj. Kanë mbjellë rreth 9500 pemë të ndryshme, si mollë, kumbulla, qershi, dardhë; kanë edhe blektori.

Nga misri, me përjashtim të vitit të kaluar, që pati thatësirë të madhe dhe s'mundën të merrnin më

shumë se 19,8 kv. pér hektar, në vitet e tjera kanë marrë 25-30, bile deri 36 kv. misër pér hektar. Dhe ajo që është më interesante, këto toka janë krejt të pavaditëshme. «Si është e mundur?» — mund të pyesë ndokush. Do të mundohemi të shpiegojmë «sekretin» e tyre. Në radhë të parë, organizata-bazë e partisë krijoj tek anëtarët një besim të madh në forcat e veta, d.m.th. u formua bindja se edhe në mes të shkrepave mund të sigurohet buka. Pastaj u studjuat eksperiencia e më të mirëve dhe u përcaktua agroteknika që do të zbatohet në kushtet e Vrithit. U vendos që toka të plugohej thellë, një pjesë e saj të bëhej qilizmë me bel, të plehërohej mirë, të ruhej nga erozioni. Për farë do të përdorej një varietet i vendit, që quhet «misër guri». U vendos gjithashtu që të sigurohen shumë bimë pér hektar, të bëhen të paktën tri prashitje.

Në Vrith bimët e misrit i mbjellin aq afër, sa kanë qenë të detyruar të bëjnë shata të vogla. Me shata të tillë bimët nuk dëmtohen gjatë prashitjes.

Nga të gjitha këto del e qartë se këtu s'ka asgjë të panjohur dhe të veçantë. E veçantë është fryma dhe mendimi i tyre revolucionar, që përshkohen nga një qëllim dhe lejtmotiv i lartë: Të shtojmë prodhimin duke u mbështetur në forcat tonë. Të mos i marrim shtetit, por t'i japim. Të ngrejmë sa më shpejt mirëqënien tonë dhe të ndihmojmë fqinjët. Dhe dihet se, kur qëllimi është i qartë, gjenden edhe rrugët pér t'ja arritur. Për ta kuptuar këtë po japim një shembull:

Gjatë muajve tetor dhe nëntor, shumica e anëtarëve, burra e gra, niseshin këtu çdo ditë drejt

pyllit, që është dy orë larg. Atje grumbullonin gjethë dushku në sasi të shumta, i transportonin ato me kafshë ose me krahë. Me këtë gjethë, përmë se gjashtë muaj të vitit, shtrojnë stallat e dhënvë e të dhive një herë në 10-15 ditë. Pastaj këtë shtroje, që është e përzier me plehun e bagëtive, kur e heqin, e vendosin menjëherë në kavaleta dhe e mbulojnë me dhe. Kështu, duke i mbajtur për një kohë të gjatë bagëtitë e imta dhe të trasha në regjim stallor, shfrytëzojnë në maksimum mundësinë për të siguruar sa më shumë pleh.

Përveç këtij plehu, anëtarët i japid kooperativës çdo vit një pjesë të plehut të oborreve personale, grumbullojnë gjithashtu fekalet e fshatit dhe i kompostojnjë, përdorin të fshirat dhe mbeturinat e tjera, kurse në pyll, përveç gjetheve për shtroje dhe ushqim të bagëtive, marrin edhe një sasi plehu të formuar në mënyrë natyrale gjatë vjeshtës nga gjethet e ndryshme. Duke shfrytëzuar të gjitha këto burime, kooperativa e Vrithit vetëm gjatë 4-5 muajve të parë të këtij viti mundi të grumbullojë rrëth 25.000 kv. pleh.

Shifrat janë me të vërtetë të mëdha po të kemi parasysh se kooperativa ka gjithsej 930 dhën, 700 dhi, 47 qe pune. Duke llogaritur plehun e grumbulluar dhe krahët e punës, del se çdo njeri i ka siguruar kooperativës mbi 100 kv. pleh. A nuk është ky një fakt, që të bind se, kur detyrat vlerësohen politikisht drejt, atëhere gjenden edhe rrugët nga më të ndryshmet për të realizuar qëllimin?

Po kthehemë edhe një herë në problemin e tokave të reja dhe taracimin e tyre. Nuk mund të parafytyrohet se ç'kanë bërë sivjet në Vrith. Që

nga fillimi i dhjetorit e deri në fund të shkurtit, në mes të borës dhe të ftohtit, kooperativistët, iu vërsulën malit për ta kthyer në toka buke. Disa lëviznin shkëmbinjtë dhe i copëtonin, të tjerë pas-tronin tokën nga dëbora, hiqnin gurët dhe e puno-nin qilizmë, të tjerë ndërtonin mure. Kështu mundën që të 96 familjet e dy fshatrave, të cilat janë bashkuar në një kooperativë (Vrithi dhe Vuç Kurtaj), të çelin përmes shkrepave dhe brenda dy-tri muajve të dimrit 30 hektarë toka të reja, a.m.th. aq sa ka patur Vrithi kur u bë kooperativë, ose sa janë çelur prej saj gjatë 5-6 vjetëve. Nga këta 30 hektarë 10 u taracuan, ndërsa e gjithë sipërfaqja u bë qilizmë. Muret e taracave të mrekullueshme do të mbeten si dëshmi e gjallë e punës vetmohuese që bënë vrithiotët pas Thirrjes dhe Letrës së hapur të Komitetit Qëndror të Partisë.

Në këtë kooperativë shikohet një realizim konkret i orientimit të partisë për bujqësinë: Toka të reja dhe plugime të thella, taraca të mrekullueshme dhe plehërim të shumtë, shfrytëzim maksimal të tokës dhe rendimente të larta, të ardhura të mira dhe shtëpi të reja, jetë plot punë e gjësim. Të gjitha këto janë shprehje të një patriotizmi të madh dhe fryme revolucionare, të një qartësie politike dhe ndërgjegjeje të lartë në punë, të një vendosmërie dhe vetmohimi për të kthyer në realitet çdo parullë e direktivë të partisë, për të ndërtuar socializmin duke u mbështetur në radhë të parë në forcat tona.

BALLKIZ HALILI

(Zëri i Popullit, korrik 1966)

## KOOPERATIVISTËT E VRITHIT E SHNDERRUAN MALIN SHKËMBOR NË TOKË BUKE

Këtë shkrim ja kushtojmë punës së njerëzve në Vrithin malor, që mendojnë dhe veprojnë si revolucionarë. Në gazeten «Zëri i Popullit» është shkruar për Taxhain e RP të Kinës. Disa ditë më parë, Vrithin tonë e vizitoi një delegacion bujqësor i RP. të Kinës. Shokët kinezë thanë: «Ja, ky është Taxhai».

Kooperativa bujqësore e Vrithit të rrethit të Shkodrës shtrihet në shpatull të malit të Veleçikut, në një lartësi 1000 e ca metra mbi nivelin e detit. Dimri këtu është i ashpër, me dëborë e ngrica, me erëra e furtuna, kurse vera e thatë e pa ujë. Bile edhe ujë për të pirë marrin nga Razma e nga burime të tjera të largëta. Arat e Vrithit janë të vogla e të shpërndara faqeve dhe grykave të malit. Nga larg ato u shëmbëllejnë kutive. Janë të rrethuara me mure në tërë atë mal të zhveshur e të thatë. Kur shikon Vrithin, të kujtohen Ujaniku i Skraparit, Dardha e Tomorricës, tokat e ashpra të Skroskës së Librazhdit, etj. Të tilla vende e të tilla toka ka kudo në atdheun tonë. Të sigurosh prej tyre gjithë bukën e vitit nuk është lehtë. Kooperativistët e Vrithit në toka të tilla shterpa sivjet do të plotësojnë nevojat e tyre me drithra buke. Ky është edhe qëllimi i shkrimit tonë, ku do të tregojmë se si ata shtuan

prodhimin e drithrave, se ku e gjetën tërë atë gu-xim dhe forcë.

Në vjeshtën e vitit 1965, sekretari i organiza-tës-bazë të partisë, Metush Ali Vuça, mendonte se edhe zonat malore mund të bëhen një krah i fu-qishëm për shtimin e drithërave të bukës në një kohë sa më të shkurtër, sipas orientimit të partisë për shtimin e prodhimit të drithit. Dhe ai e shtron-te çështjen kështu: Gjatë viteve të fundit, Vrithi e ka shtuar fondin e drithit, duke hapur çdo vit toka të reja, duke marrë nga taracat rendimente të larta misri, thekre e patatesh. Fshatarët kanë eksperiencë të pasur në ndërtimin e taracave. Ata kanë njojuri të mrekullueshme për kultivimin e misrit e të patates. Por me gjithatë, Vrithi vazh-donte të mbetej një ekonomi e varfër edhe pasi u bashkua me Vuç-Kurtajn. Shteti i jepte bukë dhe te kooperativistët e vetë drejtuesit e tyre kish zënë rrënëjë mendimi se Vrithi nuk mund të sigurojë dot bukën me forcat e veta, pasi vendi është malor, i ashpër, tërë gurë dhe ujët mungon për vaditjen e arave. Njerëzit ishin mësuar të punonin vetëm muajt e verës dhe shpesh herë jashtë Vrithit. Ata zbrisnin në fushë, ose ngrinin furra gëlqereje dhe prisnin dru në pyjet e Veleçikut. Gjatë dimrit qëndronin pranë shtëpive, duke vështruar prej dri-tareve déborën që mbulonte tërë atë pllajë dhe tokën e pakët që ngrinte si akull. Pra, duhesin kombinuar forca dhe guximi i malësorëve me bindjen e thellë se edhe në shkëmbinjtë e Vrithit mund të merrej bukë. Dhe këtë mund ta bënte vetëm organizata-bazë e partisë me një frymëzim të madh revolucionar. Dhe ajo, e frymëzuar nga Thirrrja dhe Letra e hapur e partisë, e bëri.

Komunistët diskutuan në frysë revolucionare për të gjitha ato çështje që paraqiti sekretari i organizatës së partisë lidhur me shtimin e prodhimit të drithit, në mënyrë që edhe Vrithi t'i sigurojë vetë nevojat me bukë. Ata arriten të përcaktojnë edhe objektivat kryesore, rrugët për plotësimin e kësaj detyre. Dhe ato ishin: Shtimi i sipërfaqes me anën e tokave të reja, ngritja e rendimenteve në-përmjet intensifikimit të bujqësisë. Në fillim, organizata e partisë mendoi që në vitin 1966 të çelen 16 ha toka të reja, ndërsa rendimenti i misrit, si bima kryesore, të arrijë në 25 kv. për ha. Kooperativistët, gjatë mbledhjeve për hartimin e planit të katërt pesëvjeçar, sipërfaqen e tokave të reja e rritën në 20 ha dhe përsëri, më vonë, pas botimit të Letrës së hapur, e quan në 30 ha.

Eshtë interesant fakti që të 13 komunistët e Vrithit bënë një punë të madhe bindëse e sqaruese me masën e kooperativistëve, duke qëndruar në pararojë të kësaj lufte. Ata u hodhën vetë në radhët e para të luftës në frontin e prodhimit dhe, me durim e këmbëngulje, thyen mendimet e vjetëruara lidhur me problemin e bukës dhe krijuan një ndjenjë të vërtetë revolucionare te njerëzit.

— Na kena jetue me dhi tanë jetën. A asht e mujtun me cilë 30 hektarë tokë të re në këto shkrepë, bre burra? — u tha një herë plaku Lluk Maçi bashkëfshatarëve të tij.

— Duert tona, o Lluk Maçi, po të duen, edhe në shkrepë marrin bukë. Po të parët tanë a nuk kanë cilë tokë të re në mal dhe e kanë mbajtë këtë me taraca? — iu përgjegj një nga të trembëdhjetë komunistët.

— Të parët tanë kanë cilë dy-tre dynymë, por

jo tridhjetë hektarë, — kundërshtoi Hasan Hellı, një malësor tjetër.

— Na jena të bashkuem e kena mësimet e partisë. Të parët tanë këto nuk i kanë pasë e kanë çelë pak tokë. Ne dijmë me përdorë kazmën, lopatën e qysqinë, ashtu si dhe pushkën, kur asht nevoja pér të mbrojtë interesat e vendit, — ja priti një komunist.

— Po në dimër këtej ban acar i madh. Çka me ba?

— Çka me ba? Ju ejani pas fshatarëve të tjerrë, — u përgjegj komunisti. — Do shikoni e do bindeni se të ftohit nuk i tremben burrat e gratë e fshatit tonë.

— Bindjen pér të siguruar bukën në vend, kooperativistët e komunistët e Vrithit e krijuan pa marrë parasysh vështirësitë e mëdha të terenit dhe as kërkuan ndihmën e shtetit. Ata u mbështetën vetëm në punën dhe forcat e tyre, në vendosmërinë dhe optimizmin që karakterizon tërë punonjësit e vendit. «Toka ka, thonë fshatarët. Duhet vetëm punë. Kështu do ta zhvillojmë sektorin e bujqësisë dhe nuk do të marrim nga shteti asnje kilogram drithë».

Deri në atë kohë, kooperativa siguronte 60 përqind të të ardhurave nga aktivitetet ndihmëse, si nga prerja e drurit, bërja e gëlqeres dhe ndërtimi i shtëpive. Por me aktivitetet ndihmëse nuk mund të zgjidhen kërkesat e një ekonomie bujqësore. Drejtimi kryesor ekonomik i një kooperative mund të jetë bujqësia ose blegtoria. Aktivitetet ndihmëse janë të nevojëshme brenda këtij kuadri. Prandaj kryesia dhe tërë kooperativistët u përqëndruan më shumë në bujqësi, me qëllim që të hedhin themel

të shëndosha, baza të forta për zhvillimin e ekonomisë kolektive.

Në pragun e luftës së madhe për bukën, koooperativistët nisen punën për të hapur rrugën që do të lidhte fshatin Vuç-Kurtaj me Vrithin. Kjo rrugë e gjatë 6 km, do të ishte, si të thuash, prologu i ndeshjeve të mëdha me shkëmbinjtë. Këtej do të kalonin njerëzit që do të ndërtonin taracat, këtej do të kalonte pastaj prodhimi, buka... Ky është ligj. Në fillim hapet rruga, pastaj fillon ndërtimi i një vepre. Njerëzit u derdhën në shkrepat. Me duart e tyre të ashpra e tërë kallo nga puna, ata ngulën qysqitë dhe rrëkellyen gurët. Gjëmuan disa muaj të tërë varet, kazmat, çekicët dhe rruga u hap në malin e egër. Kjo ishte një betejë e vërtetë, që trengonte forcën e madhe të kooperativistëve, ndërgjegjen e tyre të lartë revolucionare. Një betejë e tillë mund të shpërthejë me tërë bukurinë e saj vetëm kur njerëzit punojnë të bashkuar dhe udhëhiqen nga ideale të larta. Ata nuk u trëmben vëstirësive, por luftojnë me vëtmohim për të shndërruar natyrën shekullore në shërbim të popullit. Dhe pikërisht kjo i mbushi ata me optimizëm dhe u dha hov energjive të tyre.

Rruja e parë është hapja e tokave të reja. Të 30 hektarët e parashikuar duhej të gjendeshin dhe të viheshin nën kulturë brenda një kohe të shkurtër. Drejtuesit e kooperativës siguruan me kohë veglat e punës dhe muarën të gjitha masat tekniko-organizative. Aty nga dhjetori, koooperativistët e Vrithit u sulën drejt malit shkëmbor në rrëzë të Veleçikut. Ditën e parë ata qenë pak, por të nesërmë radhët e tyre u shtuan. Shumë shpejt shpatet dhe luginat e Vrithit ushtuan nga kënga e punës

së 220 kooperativistëve (kaq është numri i anëtarëve të aftë për punë), të cilët luftuan pesë muaj për të shndërruar natyrën e egër me bindje të thellë në vijën e partisë. Njerëzit nuk u tërroqën nga fronti i punës. Ata mbanin në duar kazmat dhe qysqitë. Me këto vegla të thjeshta ata hynë në luftë me shkëmbin e natyrën e ashpër.

Kooperativistët dilnin nga shtëpitë herët në mëngjes dhe ktheheshin në orët e vona të pasditës. Shtëpitë e tyre ishin larg njëratjetrës, mes shkëmbinjve. Ç'duhej bërë? Komunistët, bashkë me fshatarët, menduan të ndërtojnë kasolle të vogla pranë tokave që çelnin. Ata nuk duhej të humbnin kohën në këtë betejë të madhe për bukën. Duhej ta ndjenin veten si në front. Mes acarit ata pastronin dëborën përreth për të lëvizur pastaj shkëmbinjtë. Kur ngrinte toka, fshatarët ndiznin zjarre që të shkrihej e muri i taracës të vendosej mbi themele të forta (muret e taracave këtu nuk bëhen në sipërfaqe, por ndërtohen mbi themele të thella). Plaku Nikollë Pjetri na tregonte se si njerëzit nuk largoheshin nga shkëmbinjtë edhe kur të ftohtit të ngrinte duart. Pranë zjarrit, njerëzit shkonin vetëm atëhere, kur e ndjenin se të ftohtit po u futej në palcë. Dhe sa qëndronin pranë zjarrit? Vetëm dhjetë minuta! Lufta për bukën nuk ishte e lehtë.

Çdo njeri që viziton Vrithin, kur dëgjon tre-gimet e malësorëve për përpjekjet e tyre për të nënshtruar natyrën, entuziazmohet dhe pushtohet nga një ndjenjë e lartë krenarie. Takova në këtë fshat poetin Vehbi Bala. Ai, i frymëzuar nga puna e kooperativistëve të Vrithit, shkroi këtë vjershë:

*Na ngrihen kreshtat rrrotull Veleçikut  
krenare, ballin kunorue me re,  
her'dielli shkëndërit në mes korriku,  
herë era fryn e rrebt' si në Shëndre.*

*Ndër shpate malesh, ndër shkambinj dhe gurë,  
taracat zbardhëllojnë varg e varg,  
Malësorët mjeshtra, me të shkathtat duer,  
i ngritën kaq me shije rrëth e qark.*

*Me zjarr e ngrohën tokën ngri kallkan  
dhe, që t'mos shëmbet, vun'themele thellë;  
thërmuen shkambij e krepa e, mbi kalldram,  
shtruën dheun e zi nga pllaje tjera sjellë.*

*Shkoi dimni i egër, erdh e bardha verë;  
ja bima qysh bleron n'taraca t'ra!  
Fryt ma të kandshëm, po, se këtë herë  
malsorët thonë kurr' s'e kanë pa.*

*Fole lirie dhe burrnie, o male,  
në gji me shekuj ndryni kaq thesar!  
Sa gaz të jetës, o Atdhe, më fale  
këtu ku shtrihet një «Taxhaj» shqiptar!*

Ndërtimi i taracave në gati 10 hektarë tokë të  
re qe fronti më i vështirë. Këtu nuk është puna për  
artin e krijimit të tyre, pasi vetë fshatarët kanë një  
eksperiencë të madhe, po për faktin se taraca ndër-  
tohej në një teren shkëmbor. Ata e liruan sipërfra-

gen e malit nga shkëmbi, duke e copëtuar atë ose duke e nxjerrë nga thellësia e tij. Me këta gurë u ndërtuan muret mbajtëse të çdo tarace. Dheu ishte i pakët dhe shtrihej në faqe të pjerrëta. Atëhere fshatarët e lëviznin dheun bren- da taracës, në mënyrë që sipërfaqja të bëhej e një- llojtë. Në përgjithësi, vendi, pasi hiqeshin gurët, mbetej bosh. Atëhere dheun e sillnin me krahë ose kafshë nga vende të tjera. Kështu që, në përgjithësi, në faqet shkëmbore të Vrithit taracat janë ndërtuar mbi taban guri e sipër u është hedhur dhé i marrë nga pylli. Të 10 hektarët e zënë me taracë u mbollën gjatë pranverës me patate.

Gjatë të njëjtës periudhë, kooperativistët e Vrithit çelën 20 ha tokë të re, por jo më taraca. Ajo u gjet në përgjithësi në lugina e maleve, në toka të zëna me livadhe e kullota, ose në pyje të degradaura. Kjo qe një rezervë e madhe dhe e lehtë për t'u shfrytëzuar. Një pjesë e tyre, kryesisht kullotat, shërbenin për ushqimin e bagëtive të kooperativës dhe të anëtarëve e, megjithatë, fshatarët qenë të mendimit t'i shndrojnë në toka buke, ndërsa ushqimet e bagëtisë të shtohen nëpërmjet intensifikimit të bazës ushqimore. Ato u çelën me vështirësi të mëdha. Toka të tillë në zonën e Vrithit janë në sipërfaqe shumë të vogla e në largësi nga njëra-tjetra. Kështu, 2 ha tokë e re e fituar prej tyre përbëhet nga 44 ngastra të veçuara. Pasi këto ngastra u çpyllëzuan, u punuan qilizmë e u plehëruan, tanë janë të mbushura me patate e thekër. Gjëndja e tyre është e mbarë.

Vënia nën kulturë e 30 hektarëve tokë të re, që është e barabartë me aq tokë, sa kishte kooperativa e Vrithit në kohën e kryimit të saj shtatë vjet

më parë, përbën një rezervë të madhe për shtimin e prodhimit bujqësor. Dhe jo vetëm kaq. Komunistët e Vrithit e konsiderojnë vlerën e saj pozitive edhe nga pikëpamja edukative dhe organizative. E para qëndron në edukimin e njerëzve, sidomos të rinisë, me qëndrimin socialist ndaj punës, me futjen e tyre në një aksion të madh e të vështirë. Dimri do të jetë në të ardhmen një periudhë pune për mali-sorët e Vrithit. Këtu qëndron rëndësia tjetër e madhe e eksperiencës së dimrit të shkuar. Brenda pesë muajve të parë të vitit, vetëm për hapjen e tokave të reja, ata bënë 12000 ditëpune, në krahasim me vetëm pak qindra ditëpune që bëhen sheshin gjatë të njëjtës periudhë të viteve të shkuara. Dhe e gjithë kjo punë, sipas disa llogarive paraprake të drejtuesve të kooperativës, do të shpërblehet qysh sivjet me prodhimet që do merren nga tokat e ndërtuara taraca.

Bimët kryesore në kooperativën bujqësore të Vrithit janë misri, patatja e thekra. Fshatarët, si më parë ashtu dhe tani, janë munduar të marrin sa më shumë prodhime nga çdo njësi toke. Rendimentet arrijnë në 20-25 kv dhe, në parcela të vecanta, deri në 30 kv misër për ha. Patate merren rrëth 150 kv. për ha dhe thekër - 10 kv. për ha. Siç shihet, rendimentet janë të mira, veçanërisht nga misri e patatja. Kryetari i kooperativës, Ymer Muha, dhe fshatari Rrok Tumalaj, duke na treguar për «sekretet» e prodhimtarisë së lartë, u ndalën, së pari, në mungesën e tokës që i ka nxitur banorët e kësaj ane të punojnë me pasion për kulturën e misrit. Kjo ka bërë që të grumbullojnë një eksperiencë të pasur në shfrytëzimin e tokave, e cila

shtrihet në tërë hallkat e kultivimit të misrit apo patates...

...Edhe pak kohë mbetet që kooperativistët e Vrithit të mbledhin prodhimin e ri. Ata janë të gjëzuar jo vetëm që prodhimet paraqiten të mbara, por edhe sepse sivjet do ta sigurojnë bukën vetë. Nga sipërfaqet e zëna me misër mendohet të merrin 875 kv. dhe në ato me patate rreth 4000 kv. Me sasinë e drithit dhe të një pjese fare të vogël nga patatja do të plotësojnë të gjitha nevojat përbukë. Mbi 3000 kv. patate do t'i japin shtetit, duke dhënë kështu një kontribut të madh për plotësimin e nevojave të ekonomisë popullore.

Pas gjithë këtyre mund të thuhet me bindje të plotë se komunistët, drejtuesit dhe tërë kooperativistët e Vrithit e kanë kuptuar politikisht drejt orientimin e partisë për shtimin e prodhimeve bujqësore, veçanërisht të drithrave të bukës. Ata u nisën pikërisht nga kjo, që iu vërsulën malit duke punuar me fryshtë revolucionare dhe ndërgjegje të lartë, me një vendosmëri e vetmohim të mrekullueshëm, për të kthyer në realitet direktivat e partisë. Në këtë kuadër mund të përmendim edhe një shembull. Shtimi i sipërfaqeve të reja nën kulturë, si dhe intensifikimi i mëtejshëm i bujqësisë, bën të domosdoshëm edhe shtimin e pendëve të qeve. Në rast se do qëndrohej me atë numër pendësh, kooperativa do kishte vështirësi të madhe në plotësimin e nevojave të bujqësisë, pasi këtu çdo proces kryhet vetëm me pendë. Duke e kuptuar drejt, drejtuesit e shtruan para kooperativistëve nevojën që lindi për kafshë tërheqëse. Dhe ata nuk nguruan që t'i japin ekonomisë kolektive mëzetër e viça mesh-

kuj, në mënyrë që ajo të plotësojë sa më mirë ne-vujat e sij.

Përfundimet e arritura janë vetëm një fillim i mbarë, thonë në Vrith. Rezervat në bujqësi janë pa fund. «Ne do të hapim përsëri toka të reja, do të bëjmë taraca, do të ngrejmë rendimentet e bimëve. Kështu, gjatë dimërit të ardhshëm, na tha sekretari i organizatës bazë të partisë, do të pregetit 8 ha tokë me tara-ca, e cila ndodhet në teren të thyer. Por jemi të bindur se do të arrijmë ta plotësojmë me sukses kë-të detyrë, pasi eksperiencia e dimrit të shkuar qe një shkollë e madhe, nga e cila kemi mësuar shumë. Mbi të gjitha është qartësia politike, fryma revolucionare dhe patriotizmi i madh i malësorëve tanë, që duket në çdo hap e kudo që e kërkojnë interesat e përgjithëshme».

Vepra e kooperativistëve të Vrithit është një shembull i lartë heroizmi në punë. Ajo dëshmon për zbatimin në mënyrë krijuese të direktivave të partisë sonë në kushtet aktuale të ndërtimit të sozializmit. Prandaj kooperativistët e zonave të thella malore të vendit tonë do të gjejnë këtu një shembull të gjallë frymëzimi, një mësim të madh se si mund të krijohen toka buke edhe në vendet e thepisura shkëmbore. Kooperativistët e Vrithit po e shndërrojnë natyrën e egër të maleve, po japid ndihmën e tyre për lulëzimin e përparimin e fshatit tonë të ri socialist.

#### FATOS CEKODHIMA

(Zëri i Popullit, korrik 1966)

## TOKA E BRAKTISUR

Ata ecin njëshkollonë. Nuk janë një, as dy, as tre. Janë dhjetra njerëz. Ecin njëshkollonë në të përpjetën e malit. Kjo nuk është një rrugë e zakonëshme. Ajo është rrugë mali. Një rrip i ngushtë toke, ku mbijnë bari e trëndelina. Është e heshtur, ashtu siç është i heshtur edhe pylli që e rrethon. Ajo duket e veçuar, e futur diku thellë në këtë botë të gjelbërimit shekullor.

Ku shkojnë këta njerëz? C'janë këta?

Këta nuk janë alpinistë. As vullnetarë. Në supa mbajnjë kazma e bela. Në këtë muzg janari siluetat e tyre maten me hien e pemëve të pyllit. Këta janë fshatarë. Edhe tiparet e tyre, me ato vijat karakteristike si të gdhëndura me daltë, janë po fshatare. Edhe toka ku shkelin është po tokë fshatare. Por kjo nuk është një ngjitje e zakonëshme. Dikur këtej kalonin vetëm dhitë e barinjtë. Njerëzit duke shin rrallë. Këto quhen vende të pashkelura. Por ky përfytyrim mbi tokën e «pashkelur» duket tanë si diçka i largët. Ky vend i «pashkelur» u shkel. Edhe këtej erdhi njeriu.

Atje, në majë ka një pllajë të vogël, ku rritet bari e kullotin bagëtia. Toka këtu është e pakët. Ka më tepër gurë, të cilët e shkallëzojnë atë si këmbët e një amfiteatri. Në këtë «amfiteatër», në majë të malit, njerëzit kanë jetuar. Atje janë ndeshur me

natyren. I kanë rrëmbyer tokës pjellorinë. Kanë mbjellë grurë. Atëhere ky grurë ka qenë pér ta burim jete. Burim pune. Burim përpjekjesh. Në çdo gur ka gjurmë të duarve njerëzore. Ka gjurma gjaku.

Ky nuk është një «amfiteatër». Atje nuk jepe-shin çfaqje argëtuese skllevërish. Ky ishte vend pune. Vend jete. Por ishte njëkohësisht një vepër arti. Vepër e duarve dhe e mendjes njerëzore. Vepër e atyre që s'kishin tokë. Por që toka u duhej. Dhe ata erdhën këtu në Konjak. Kështu quhet ky mal i lartë, ku bënин «kuvend perënditë». Atje poshtë shtrihet Joni. I kaltër, i kthjellët, siç është i kthje-llët, qielli i atdheut tonë. Atje poshtë rriteshin ulliri e portokallja.

Këtu, në Konjak, natyra është më pak bujare. Është më e ashpër, më e egër. Por kjo nuk i shqetësonte njerëzit. Ata nuk kishin ardhur të soditnin natyrën. Kishin ardhur të punonin. Të mbillnin bukë. Dhe natyra iu bind atyre. Iu nënshtroa, siç i nënshtrohet në arenë demi toreadorit.

Konjak! Është emër i çuditshëm ky emër i kë-tij mali të Pijerasit. Shikoni hartën gjeografike. Edhe po të mundoheni, nuk do ta gjeni dot një emër të tillë. Por Konjaku ekziston. Ekzistonte edhe më parë. Por ishte një vend vetëm pér bagëtitë. «Amfiteatri» ishte shkatërruar. Shkallët e kishin humbur formën e tyre të dikurshme. Atje bariu ja merrte përmallshëm këngës. «O ç'bukuri ka tufa». Nuk e kujtonte njeriu grurin. As punën e të parëve.

Kurse tani ky mal prapë është zgjuar. Ky Konjaku i ditëve tona të kujton atë Konjakun e vjetër, por të përtëritur. Ai shënoi lindjen e një en-

tuziazmi të ri, të njerëzve të rinj, të denjë ta shpi-en përpara stafetën e baballarëve të tyre.

Ecin njëshkollonë piqerasjotët. Kështu kanë ecur gjithnjë. Në ato monopatet e ngushta ka rrjetdhur jeta e tyre. Zgjatet rruga si një nyje e padukëshme në të përpjetën e malit. Ja edhe mali i Konjakut. Tokat e pjerrëta janë sistemuar. Gurët janë kthyer përsëri në vendet e tyre. Në këto ngastratë vogla toke gjelbëron gruri. Ky është gruri i ri, që mbiu në atë tokë gjer dje të braktisur. Njerëzit i ktheyen Konjakut përsëri jetën. E bënë atë majë mali të ndryshojë ngjyrën.

Kështu e gjeta unë. Por nuk ka qenë gjithnjë kështu. U desh një rrugë e gjatë, plot zigzage, që të arrihej deri këtu. Ajo, që sot duket një mrekulli, dje për shumë njerëz ishte një ëndërr, një utopi. Dhe ja përse.

E pyeta Niko Aliun, kryetarin e kooperativës:

— A mbillnit grurë më parë?

— Asnjë kokërr.

— Pse?

Ai hesht një çast.

— Pse ta fsheh? — thotë pas pak. — E kishim më lehtë ta merrnim të gatshëm, nga shteti.

— Gruri s'ka qenë i panjohur për Piqerasin, — i them unë.

— Jo. Vite më parë është mbjellë. Ja, atje në malin e Konjakut.

— Po ju pse hoqët dorë?

— Nguronim. Mendonim si ai tregëtar. Kur kemi ullirin, portokallet, që na japin shumë të ardhura, — thoshim, — ç'na duhet gruri?

Kështu ishte me të vërtetë. Por kështu nuk mendonte vetëm kryetari. Edhe të tjerët e shikonin

mbjelljen e grurit në një prizëm të ngushtë, thjesht si një qështje të ardhurash. Ky koncept kishte zënë rrënje thellë në bregdetasit. Është tipik rasti i fshatit Sasaj, që u bashkua para ca vitesh me Piqerasin. Sasanjotët e mbillnin grurin deri vonë. Ata e bënин bukën pothuajse për gjithë vitin. Edhe Sasaj s'ka shumë tokë. Por ata kishin një mal, si mali i Konjakut, Lavanin. Atje në Lavan, sasanjotët denbabaden kishin bërë taraca. Në ato taraca mbillnin grurë. Dhe gruri bëhej për bukurin. Natyrisht, nuk ishte punë e lehtë të mbillje grurë në mal. Fshati ishte larg. Njerëzit bënin një rrugë të gjatë për të vajtur gjer atje. Por prapë ata nuk hiqnin dorë nga Lavani. Ai ishte hambari i tyre.

Kur u bashkuan me Piqerasin, ndodhi një çudi. Sasanjotët hoqën dorë nga gruri. «Ç'na duhet gruri, — thoshin ata, — kur kemi ullirin e portokallet. Apo që të na bjerë bretku gërxheve të Lavanit». Dhe u braktisën taracat e u bënë sheshe. U lëshuan në to bagëtia. E mbuluan tokën cfaka dhe gurët. Kështu u kultivua rehatllëku. Nëqoftëse zyrat punojnë deri në orën dy e gjysmë, në Piqeras ktheshin nga puna që në orën një. «Ja e bëmë punimin e tokës rrëth ullirit ose vaditjen e portokalleve, po pastaj?» — thoshin kooperativistët. Grurë nuk mbiilej, patate gjithashtu jo, domate shumë pak. Atëhere, rroftë klubi. Në çdo orë të ditës e të natës klubi ishte plot. Kërcisin rakia e muhabeti për shtatë palë qejfe.

Kështu ndodhët. Por kështu nuk ndodh më. Si ndodhi kjo çudi? Kush e prishi qetësinë e burrave piqerasjotë? Kush i bëri ata të lënë kafenenë dhe t'i ngjiten përpjetë malit të Konjakut apo të Lavanit?

Çudia ndodhi atë ditë kur u punua Thirrja e partisë. Partia thoshte: «Ta bëjmë bukën vetë. Të shfrytëzojmë çdo pëllëmbë tokë». Njerëzit u shkundën nga plogështia. Filluan të mendojnë ndryshe. U çfaqën atëhere shumë mendime. Jo një e dy, por dhjetra njerëz u ngritën kundër këtij rehatllëku mikroborgjez, kundër prirjes «për të xhvatur nga shteti» edhe bukën, atë bukë që ata vetë e kishin prodhuar më parë.

— Pse të mos i ngjitemi malit? — tha në mbledhje brigadierja Angjeliqi Leka.

— Është marrëzi kjo që thua, moj Ngjelë, — e kundërshtoi bariu i kooperativës, Milo Nika. — Nuk mbillet Konjaku, jo! Ja ku ta thotë Milua ty. Po dhentë me se do t'i ushqejmë, me portokalle?...

Këtë mendim e përkrahën atëhere edhe të tjerrë. Nënkyryetari i kooperativës, Zenel Resvani, tha:

— Kot e kini. Nuk bëhet gruri atje.

Ziente salsa nga diskutimet. Një palë thoshin të mbjellim grurë në Konjak, të tjerë e kundërshtonin këtë mendim.

U ngrit në fund plaka 66 vjeçare, Kana Konomi:

— Turp, more djema, që flisni kështu. Si ore s'u bëka gruri në Konjak? Ja ku është këtu Katerina Prifti. Ajo e mban mend kur kemi mbjellë atje bashkë. Kemi marrë bukë. Unë kam arën time të vjetër në Konjak. Hajde vemi së bashku. Kini për të parë ç'grurë i mirë ka për t'u bërë.

Kështu u mposht ngurimi.

Të parët që u nisën për në Malin e Konjakut ishin brigadierja Angjeliqi Leka dhe brigadieri Mitro Çuni me anëtarët e tyre. Shkuan atje 66 vjeçarja Kana Konomi, 60 vjeçarja Katerina Prifti, gra

të moshuara, si Rina Mati, Eftimi Voda e shumë të tjera. I riu Leka Spiropali vinte në malin e Konjakut për herë të parë. Tani njerëzit filluan të mendonin më shumë për malin.

— Ku shkon? — pyeti një vajzë shoqen e vet.

— Në Konjak.

— E, si shkon gruri? Po mbillni?

— Posi! Është një tokë, për kokën e tokës ajo, — iu përgjigj vajza dhe iu ngjit malit përpjetë.

Atje, në Konjak, njerëzit krijuan një kantier të vogël. U ngritën dhoma fjetjeje. Gratë e moshuara kundërshtuan të ktheheshin në mbrëmje në fshat. «Pa mbjellë grurin, nuk kthehemë në shtëpi» — thoshin ato.

— Po këtu është pyll, moj gra, —i ngacmonte Kana. — Si do bëjmë vetëm, pa ndonjë burrë?

— Qëndroj unë, — u tha i riu Leka Spiropali, — po qe se më pranoni për kavalier...

— Si ore s'të pranojmë! Ne ku ta gjejmë një kavalier si ty, — qeshnin plakat.

Kështu kaluan ditët. Njerëzit u mësuan me malin. Dhe mali u miqësua me ta. Ajo tokë e braktisur u ripërtëri, mori përsëri frymë pas kaq e kaq vjetësh. Pendarët hodhën farën.

Në tokën ngjyrë kafe tashti shikon filizat e gjelbër. Duket i mbarë ky gruri i malit të Konjakut.

Ta korrni gëzuar, shokë!

### VANGJUSH ZALLEMI

(*Zëri i Popullit*, mars 1966)

## NE SPITEN FILLOI KTHESA KUR POLITIKA U VU NE PLAN TE PARË

Përpara disa vjetësh, kur Pal Hyseni hodhi themelet e shtëpisë së tij në majë të malit, askush nuk u habit në fshat. «Mali na mban, — thoshin atëhere fshatarët e Spitenit, — ai na jep të hamë. Sa përfushën e kemi të gjanë boll, por nuk e gjëzojmë dot».

Ky koncept ishte rrënjosur thellë në mendien e tyre. Dhe ai kishte bazën e vet. Gjer tre-katër vjet më parë, fusha e gjerë e Bregut të Matës në rrëthim e Lezhës përmbytej. Vëndasit mbillnin pak dhe merrnin prodhime të ulta. Shpesh prodhimet e tyre i mbulonte balta, ose i rrëmbenin valët e lumit e të përrrenje dhe i çonin në det.

Ndërsa tani plaku Pal Hyseni sheh nga dritarja e shtëpisë së tij gjithë atë fushë pjellore e të lulëzuar dhe zemra i mbushet me krenari. Këta vjet që vazhdoi bonifikimi, axhë Pali s'ngopej së pari. Ai rrinte orë të tëra majë ndonjë guri dhe vështronët me habi dhe me një ndjenjë të thellë gjëzimi e krenarie eskavatorët dhe buldozerët e fuqishëm që kishte çuar partia dhe pushteti popullor për t'i ardhur në ndihmë fshatarësise së shumëvuajtur të kësaj zone, shihte kanalet e gjëra dhe të gjata deri në brigjet e detit që mbusheshin plot me ujë, pritat e betonuara elektropompat që thith-

nin ujin dhe e derdhnin në bregun e detit dhe uronte mijra herë: «Rroftë sa malet partia jonë, që na shpëtoi për gjithmonë nga dallgët e tërbuara të Matit, nga kjo bishë e egër që na ka pirë gjakun dhe djersën brez pas brezi!»

Bonifikimi i fushës së Bregut të Matës i dha frutet e tij. Vitin e kaluar, anëtarët e kësaj kooperative mbollën shpejt dhe muarën prodhime të larta, që nuk ishin marrë asnjëherë në të kaluarën. Ndërsa vitet e mëparëshme, përpara bonifikimit, në zonën fushore mbilleshin parcela të shkëputura (gjithsejt 20-30 ha tokë), tanë vetëm sipërfaqja e mbjellur me misër ka arritur në mbi 150 ha. Rendimentet u rritën shumë. Kështu misër nga 5-6 kv. për ha që merrnin përpara, vitin e kaluar muarën mesatarisht 23 kv. për ha. Edhe në bimë të tjera rendimentet janë të kënaqshme.

Këto rendimente të mira, të cilat u arritën si rrjedhim i bonifikimit të fushës dhe i punës më të organizuar të kooperativistëve, ngjallën një gëzim të madh në fshat. Kooperativistët u lidhën më ngushtë me ekonominë e përbashkët dhe filluan të punojnë më mirë për forcimin e saj të mëtejshëm.

Pal Hyseni dhe bashkëfshatarët e tij nisen ta shohin fushën me tjetër sy. Mendimet e vjetra se «fusha nuk na mban» ndryshuan. Te kooperativistët e Spitenit lindën koncepte të reja.

Jak Pjetër Deda, sekretar i organizatës bazë të partisë, me shokët e tij komunistë kishin tanë, pas bonifikimit, një armë të shëndoshë për punën politike me kooperativistët, për t'i bindur ata që të shfrytëzonin gjithë rezervat e mundëshme dhe për të hapur perspektiva të reja për forcimin e mëtejshëm të ekonomisë së përbashkët.

Thirrja e partisë dhe qeverisë dhe Letra e hapur e Komitetit Qëndror të PPSH u erdhën në ndihmë komunistëve të kësaj kooperative. Vjet këtu u muarën prodhime të larta. Por megjithatë, buka nuk u sigurua për gjithë vitin. Kjo e preokupoi kryesinë e kooperativës, organizatën bazë të partisë dhe gjithë kooperativistët.

Idetë e mëdha revolucionare të Thirrjes së partisë dhe qeverisë nuk u kuptuan menjëherë nga kooperativistët. Gjatë diskutimit dhe hartimit të planit të katërt pesëvjeçar pati lëkundje. Disa thoshin: «Të mos avancojmë më tej. Boll kena, po të marrim aq sa muerëm vitin që kaloi. Nuk i dihet kohës, as lumi; mund të përmbytena përsëri. Ma vonë shohim e bajmë».

Në ditët e para të janarit të këtij viti, në Lezhë ranë reshje të mëdha. Elektropompat e Tales pësuan avari dhe një pjesë e fushës u mbush me ujë. Kooperativistët e Spitenit ishin në ankth. Ata u trëmbën për të lashtat. Por nuk shkuan as pesëgjashtë ditë dhe kanalet e mëdha e përpinë ujin dhe e çuan në det. Grunjrat bleruan përsëri dhe nisën të zhvillohen. Kjo ishte një provë tjetër që ngrohu zemrat e kooperativistëve dhe që i lidhi më fort me ekonominë e përbashkët. Komunistët dhe agjitatoret e tjerë të fshatit e shfrytëzuan këtë rast për t'i bindur kooperativistët për suksesin dhe për të shtuar besimin në forcat e tyre.

Pas botimit të Letrës së hapur të Komitetit Qëndror të PPSH, organizata bazë e partisë e kësaj kooperative zhvilloi një punë të gjërë politike e propagandistike me kooperativistët. Komunistët filluan të mendojnë dhe të punojnë si revolucionarë.

Jak Pjetër Deda, që ishte nënkyrytar i kooperativës e merrej më shumë me punë administrative, nuk mund të fliste për vështirësitë që delnin për realizimin e detyrave të avancuara të planit të katërt pesëvjeçar e as për mënyrën e kapërcimit të tyre kur mendonte se pak a shumë bënte një punë «burokratike». Duke i kuptuar drejt idetë revolucionare të Thirrjes së partisë e qeverisë, Jaku kërkoi vullnetarisht të shkonte në prodhim në sektorët më të vështirë. E ngarkuan të drejtonte brigadën më të prapambetur në tokat më pak prodhuese. Tani ndryshonte puna.

Shembulli i sekretarit të organizatës bazë të partisë ndikoi për mirë edhe te komunistët e tjerë. «Jaku e la administratën. Po ne ç'presim?» — i thoshin ata njëri tjetrit. «Vendet e rehatëshme nuk janë për ne. Komunistët duhet të jenë në ballë të frontit kryesor të prodhimit, aty ku punohet dhe luftohet për bukën, ku janë vështirësitë». Dhe këto vende filluan të boshatisen dhe të braktisen. Gjon Marka Kola, magazinier i kooperativës, shkoi punëtor prodhimi në fushë. Mark Gjergji, shitës i dyqanit-shtëpi, u bë pjesëtar i një brigade arash, etj. Nga 16 komunistë që ka kooperativa, 14 u hohën në prodhim.

Duke qenë vetë në frontin e prodhimit, në sektorët më të vështirë, komunistët filluan të flasin ballëhapur me kooperativistët, të propagandonin idetë e mëdha të Thirrjes së partisë e qeverisë dhe Letrës së hapur të Komitetit Qëndror të PPSH dhe të frymëzuar nga këto dokumenta të rëndësishme, nisën ta shohin çdo gjë me syrin politik. Ata u thonë bashkëfshatarëve të tyre se sigurimi i bukës në vënd nuk është vetëm aksion i thjeshtë ekono-

mik, por, në radhë të parë, një çështje e madhe politike. U kujtojnë rrethimin kapitalist e revizionist dhe parullën luftarake e revolucionare të partisë: «Të ndërtojmë socializmin me forcat tona, duke mbajtur në njerën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën», etj.

Puna edukative që bënë komunistët për të vënë politikën në plan të parë, e ngriti ndërgjegjen e kooperativistëve dhe i zhvilloi më tej konceptet e reja që kanë lindur tek ata. Shumë prej tyre filluan të kuptojnë drejt politikën e partisë në çastet e sotme revolucionare që jeton i gjithë populli ynë, të vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin vetiak dhe të punojnë më mirë për forcimin e mëtejshëm të ekonomisë së përbashkët, për t'i dhënë popullit e atdheut më shumë drithra buke, bimë industriale, perime e prodhime blektorale.

Në këtë kooperativë ishte zakon që, gjatë dimrit, të mos punohej. Kurse sivjet u thye ky zakon i keq. Në janar, në shkurt dhe në mars, në ditë të ftohta dhe me shi, anëtarët e kooperativës hapën kanale e vija kulluese të futur në ujë deri në brez, ndërtuan taraca në vende të thepisura, bënë qilizëm, mbuallën patate. Kështu u krijuau bindja se edhe në stinën e dimrit paska front pune.

Por jo të gjithë kooperativistët delnin në punë. Kishte nga ata që i bënë bisht asaj, sorollateshin posht e lart nëpër tregun e Lezhës dhe e kalonin kohën kot. Te këta njerëz e përqëndruan vëendenj komunistët e fshatit.

Zef Gjin Prenga, në lagjen e Prullit, është nëntë frymë në familjen e tij. Mirëpo vitin e kaluar pjestarët e kësaj familjeje nuk bënë asnje di-

të pune në arat e kooperativës. Vetë Zefi punonte në kantierin e bonifikimit të Treshit, ndërsa Lleshi djali i tij, në një ndërmarrje tjetër.

Sekretari i organizatës bazë të partisë u takua disa herë me Zefin, i shkoi në shtëpi dhe bisedoi me të për kushtet e reja që janë krijuar pas bonifikimit dhe për entuziazmin e shpërthyer pas punimit të Thirrjes së partisë dhe qeverisë. Edhe vetë Zefi i shihte bashkëfshatarët e tij që i ishin qepur fushës dhe malit, që punonin në kanalet e mbushura plot me ujë dhe i bënte përshtypje. Ai filloi të mendojë për këtë dhe i vinte turp, sepse i dukej sikur të gjithë shokët e përbuznin.

Ato ditë që u punua Letra e hapur e Komitetit Qëndror të PPSH, Zef Gjin Prenga erdhi në kryesinë e kooperativës e tha:

— Më falni, shokë. Tani e shoh se kam qenë i gabuar. Do të punoj në kooperativë bashkë me ju, ku të jetë më vështirë.

Pas disa ditësh u kthye në fshat edhe Lleshi. Tani pjestarët e kësaj familjeje janë bërë nga aktivistët më të mirë të kooperativës.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti në këtë kooperativë u bënë 12.000 ditëpune më tepër se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Mesatarja e ditëve të punës për çdo krah u shtua gati 40 ditë më tepër se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Pas punimit të Letrës së hapur, organizata bazë e partisë e kësaj kooperative u vu në pozita më revolucionare. Sekretari i organizatës bazë të partisë, Jak Pjetër Deda, filloi të mendojë: «Vjet, koperativa mori 23 kv. misër për ha, ndërsa këtë vit brigada jonë është zotuar të marrë 25 kv. për ha. A nuk është i ulët ky rendiment? Mos vallë kanë

**kushte më të mira në Zejmen, ku disa brigada janë zotuar të marrin sivjet dyfishin e këtij prodhimi? Jo. Po atëhere q'duhet bërë? E qartë. Duhen avancuar zotimet!»**

Disa ditë më parë kooperativistët diskutuan projektdirektivat e kongresit të 5-të të partisë. U bënë propozime të shumta e të guximshme. Kooperativistët e Spitenit hartuan një plan revolucionar duke rritur zotimet. Ata janë të bindur tani plotësisht se po të mendohet e të punohet në mënyrë revolucionare, ashtu siç thotë partia, s'ka gjë që s'bëhet.

Tani po mendohet për të gjetur toka të tjera, në mënyrë të veçantë në kodrat dhe malet, ku do të ndërtohen taraca. Kooperativa e Spitenit, nga një ekonomi e prapambetur, po bëhet model, një nga më të përparuarat në rrethin e Lezhës. Kjo kthesë e madhe u bë si rrjedhim i vënies së politikës në plan të parë, i kuqimit të thellë të detyrave të reja që shtron partia dhe qeveria në momentet e sotme, i mobilizimit të të gjithë kooperativistëve.

### **JANI TOÇKA**

*(Zëri i Popullit, gusht 1966)*

## NJË PËR TË GJITHË, TË GJITHË PER NJË

Në ditët e para të këtij muaji, në fshatrat e lokalitetit të Sllovës, rrëzë Korabit, filloi aksioni i madh i gjithë fshatarësise së lokalitetit nën parullën: «T'u vimë në ndihmë fshatarëve të Sllatinës dhe Venishtit që e kanë të vështirë punën për të sjellë ujë».

Fshatarëve të Sllatinës u qante zemra për një pikë ujë. Mirëpo disa teknikë, për vite me radhë, nguronin për t'ja hyrë një vepre të tillë, siç është ky kanal, që do të kalojë nëpër shkëmbin e fortë, me zigzage e humnera të shumta. Komisione pas komisionesh u formuan, por në to mbizotëronte «mendimi teknik», që i vinte vështirësitë në plan të parë dhe i paraqiste si të pakapérxyeshme, sidomos për shkak të mungesës së disa materialeve deficitarë. Ata e shihnin të pamundur fillimin e punimeve në këtë vepër, sepse nuk kuptionin forcën revolucionare dhe shpirtin krijues të masave punonjëse. Ja sepse kundërshtonin me të madhe këmbënguljen e teknikut popullor 73 vjeçar, Gani Tuçepi, i cili, duke u bazuar në eksperiencën e mendimet e popullit, thoshte se ishte plotësisht e mundëshme hapja e kanalit me forcat e tyre.

— Për të ndërtuar këtë kanal duhen 2-3 km. tuba hekuri dhe, megjithëkëtë, vështirë që të sjetëllë ujë, — kishin thënë specialistët.

— E ndërtojmë me lugje druri, — tha tekniku popullor Gani Tuçepi. Ganiu ka mësuar nga eksperiencia, se, kur ekziston vullneti dhe dëshira e masave, nuk ka gjë që të mos bëhet. Prandaj edhe specialistët u tërhoqën kurse Ganiu me frymën e partisë në shpirt, mori përsipër të drejtonte punimet në veprën më të vështirë të ujites që është ndërtuar deri më sot në rrethin e Dibrës.

Më 4 gusht, qindra fshatarë, të udhëhequr nga komunistët, filluan sulmin për ndërtimin e kanalit. U ngriten në këmbë 16 fshatra me parullën e partisë «Një për të gjithë, të gjithë për një». Kjo tregon frymën e lartë të solidaritetit të njerëzve tanë. Këta fshatarë që ndërmorën këtë vepër, i shtyu fjala e partisë, dashuria për atdheun dhe për shokët e Sllatinës e të Venishtit, të cilët kanë vuajtur brez pas brezi nga thatësira.

Nga informacioni i parë që erdhi në komitetin e partisë të rrethit të Dibrës, njoftohet: «Sot, më 4 gusht, qysh në orët e para të mëngjezit filloj puna. Morën pjesë 745 forca. Gjatë ditës u bë traseja e vijës prej 2 km. Në ndihmë të popullit, erdhën edhe kufitarët e Venishtit. Gjatë punës ka patur edhe mjaft gjallëri, lodër e curle. Puna vazhdon me një entuziazëm shumë të lartë».

Porosia e partisë për të prodhuar bukën vetë, i bëri fshatarët e kësaj krahine të mendojnë thellë politikisht dhe të ndihmojnë edhe shokët e tyre që të ecin së bashku krah për krah për ta realizuar sa më mirë e më shpejt këtë detyrë të madhe.

Plaku 80 vjeçar, Elez Pira, shumë i emocionuar na tha: «Dikur këtu hidheshin dy-tri batalione në sulm për çlirimin e vendit. Sot ne u hodhëm si partizanë<sup>+</sup> në sulm për t'i sjellë ujë Sllatinës. Edhe

sikur bukë e kripë të hamë, jashtë të flemë, shkëmbin do ta çajmë dhe ujin që buron në bjeshkë, do ta çojmë në arat e kooperativës bujqësore për të prodhuar sa më shumë drithë, për ta bërë atdheun më të fortë».

Kështu thonë dhe veprojnë këta malësorë, që po çajnë kanalin 16-18 km. të gjatë dhe që do të ujitetë mbi 100 ha tokë.

Ja pamja e një dite pune në këtë aksion... Të gjithë fshatarët vinë në punë të organizuar dhe të gjenguar. Ata kërkojnë vetëm front pune. Këtu punojnë fshatarë, kooperativistë, arësimtarë, ushtarakë të krahanës. Secili përpinqet të plotësojë i pari pjesën që i takon. Kështu p.sh, çerrenasit përfunduan pjesën më të madhe të rrafshimit në grykën e kanalit. Shëmbullin e tyre e ndjekin të gjithë. Arësimtarët, që japid mësim në këto fshatra, erdhën në punë së bashku me popullin. Ata punojnë shumë mirë. Entuziazëm të ringjalli gjesti patriotik i kufitarëve, të cilët erdhën për të punuar së bashku me vëllezërit e tyre.

Puna vazhdon pa ndërprerje. Fshatarët janë të vendosur që ta përfundojnë këtë vepër të re me çdo kusht, sepse duan të tregojnë se si imposhten vështirësitë, kur në shpirt ka hyrë thellë fjala e partisë. Këta fshatarë, që shkuan në ndihmë të shokëve të Sllatinës, do të qëndrojnë aty deri në fund. Por tani sapo u njoftua se një gatishmëri të tillë për t'u ardhur atyre në ndihmë kanë çfaqur edhe kooperativistët e lokalitetit të Fushë-Alisë.

Kanali i Sllatinës do të ndërtohet në saje të solidaritetit të malësorëve. Përpëra forcës dhe

krijimtarisë së popullit, pérpara fjalës së zjarrtë  
të partisë, që e ngre atë peshë, po ulin sot kokën  
shkëmbinjtë krenarë të Korabit plak dhe i bëjnë  
rrugë ujit, bukës.

OSMAN ALLKJA

(Zëri i Popullit, gusht 1966)

## TOKAT, QË NESËR DO TË JAPIN BUKË

### 1. Mali

Shtëpitë e Podgorisë, ca shtëpi të forta prej guri bojëhiri, janë ndërtuar pranë e pranë njëra tjetrës në rrëzën e Malit të Thatë. Ato i kthejnë shpinën malit e dyert e tyre vështrojnë në fushën e vogël, që shtrihet para fshatit, rrëthuar me ca kodra të vogla bërë qilizmë. Me këtë vendosje të shtëpive, njerëzit sikur kanë dashur me kohë të tregojnë dashurinë e tyre për fushën dhe një mëri të heshtur dhe bile zemërim për malin shkëmb e gurë. Njeriu që erdh e u vendos këtu, një mëngjes u ngrit e shkoi në lëndinat përballë fshatit, mbolli gjer në mbrëmje dhe u kthyen në darkë në shtëpi. Pastaj erdhi koha e të korrave e qysh atëhere ai u lidh me fushën dhe e shikonte atë si një nënë të mirë që i jepte bukën.

Kurse malin... malin as që donte ta vështron-te fare. E ç'të mira shihte njeriu nga mali? Ai ish një mal i xhveshur, ku s'rritej asnjë fije bari; në dimër nga ai rrukulliseshin gurë, që dëmtionin fushën; në netët e ftohta që andej vinte një acar i hidhur që të mpinte si pikë. Njeriu e mori inat këtë mal për shterpësinë e tij. Sa e sa herë i mallékuan njerëzit gurët e tij që vinin e zinin tokën, sa e sa herë i mallékuan burimet e tij që s'lëshonin një pikë uji për të vaditur fu-

shën e zhuritur. Po më në fund njerëzit e pranuan malin si një pikë të fatkeqësisë së tyre, i vunë një emër, Mal i Thatë, që shprehte shterpësinë e tij dhe me kohë sikur e harruan fare atë. Shkonin e vinin njerëz në këtë jetë, lindnin e rriteshin, po asnjëherë s'i kthyen sytë nga ky mal. Ai ngrihej mbi shtëpitë e tyre si një përbindësh kërcënënjës e i gjithfuqishëm dhe njerëzit e ndjenin veten të tulitur para tij. E kush mund të matej im të?

Mbase pat ndonjë njeri që donte të matej me këtë mal, po mali s'e përfilli fare njeriuun e vetëm. «Ti je shumë i vogël që të më nënshtrosh mua», — i tha ai njeriut dhe njeriu i vetëm me të vërtetë ishte shumë i vogël që të matej me të.

## 2. Rrugës për në taraca....

Shkojmë për në Podgori. Para ca ditësh ka rënë dëborë e ajo tashti ka ngrirë nga erërat e ftohtë që fryjnë nga mali Ivan. Arat, drurët e shkurret zbardhin nën këtë shtresë kristaline dhe nëpër gjerdhe herë herë duken gushëkuqët e shushatur nga dimri, që fluturojnë linkthi me tokën. Degët e plepave shkëlqejnë si shufra okite nën rrezet e një dielli dimërak, që është ngritur mbi malet me dëborë, kurse në hendeqe duken bllanat e lëmuara të ujit të ngrirë. Rruga, plot vraga qerresh e dëborë të llapashitur, dredhon në qafën e një kodre, pastaj zbret buzë ca arave të lëruara.

Në oborrin e kryesisë së kooperativës qëndronin tre-katër vetë në këmbë dhe pinin duhan.

Iu afroam dhe u përshëndetëm me ta. Njëri prej tyre, një burrë i gjatë me fytyrë të hequr, është kryetari i kooperativës, Rakip Vinçani.

— Kemi dëgjuar për taracat që nisi të hapi rinia tek ju, — i themi, — dhe ja, siç e sheh, dualëm një herë këndeja.

— O, shumë mirë keni bërë, — na thotë ai, duke vështruar me ata sytë e gjallë nën vetullat e rëna.

Hyri në zyrë, bisedoi me nja dy-tre vetë dhe pastaj u nisëm për në taraca.

— Ftohtë! — i them unë.

— A, lere mos e pyet. Pastaj ky vendi ynë është një çikë si ters; dimrit të grin era, kurse në verë nxehet guri e të plas vapa. Është vend i xhveshur i uruari. Ja, një dru s'të zë syri rrëth e rrëth.

— Po ja, tashti ju po hapni taracat dhe mbas disa vjetësh do të keni vreshta të mira, — i them unë.

— Doemos, doemos, — ja bën ai. — Që thatë ju për taracat. Në fillim ne do t'i mbjellim me misër, pastaj dalngadalë do t'i bëjmë vreshta. Duhen shumë fidana, pastaj ne kemi nevojë hë për hë pér toka buke.

— Po sa hektarë tokë do të hapni?

— Shiko si është puna, — thotë ai. — Ne këtë vit do të hapim 81 hektarë tokë të re, veç taracave, kurse taraca, gjer në vitin 1970, do të hapim gjithë e gjithë 80 hektarë.

Ne bisedonim dhe ecnim përmes arave të ngrira. Atje lart dukeshin një grumbull njerëzish që punonin me nxit. Njerëzit ishin hapur varg gjatë

të shpatit të malit dhe që andej vinin zëra të mbytur.

— Këtu e paski nisur me taracat?

— Po, — thotë kryetari. — Tashti për tashti ne kemi vënë 250 vetë që të punojnë në taraca, po së shpejti ky numër do të arrijë në 700. Këtë vit mendojmë të hapim 13 hektarë.

Ndërkohë që bisedonim, qemë ngjitur lart.

### 3. Inisiativa e rinisë

Aty nga ora 9 e atij mëngjesi, atje poshtë, në rrugë, u duk vargu i gjatë i nxënësve të shkoilës. Klasat e pesta dhe të gjashta të shkollës së fshatit kishin orën e punës praktike dhe ata vinin për të ndihmuar të rriturit në hapjen e taracave. Fëmijtë u ngjitën me nxit në shpatin shkëmbor të malit, erdhën në vendin e punës dhe u shpërndanë nëpër brigada. Filluan pastaj, duke shkuar i resht njëri pas tjetrit, të mbajnë gurë nga mali e t'ua sjellin muratorëve. Ata i shoqëronte Ferit Çami sekretar i komitetit të rinisë së kooperativës bujqësore.

— A mund të na tregoni si lindi inisiativa juaj për të hapur taraca? — e pyetëm.

Feriti na tregoi:

— Ne kishim dëgjuar se në shumë kooperativa bujqësore, në Bitinckë për shembull, po hapeshin taraca për vreshta ose për toka buke, po hë për hë s'na mbushej mendja se edhe tek ne mund të bëhej një punë e tillë. Siç e shihni dhe vetë, mali ynë është fare i shkretë e s'ta kap

mendja nga ku mund ta nisësh më parë. Po, në fund të fundit, asgjë s'është e pamundur.

— Të rinjtë e të rejat e kooperativës sonë, të frymëzuar nga Thirrja e Komitetit Qëndror dhe e Këshillit të Ministrave, vendosën njëzëri që t'i kthejnë gjithë shpatet në rrëzë të Malit të Thatë në taraca për toka buke. Insiativën tonë e përkrahën organizata bazë e partisë dhe kryesia e kooperativës, të cilat u treguan të gatëshme dhe na ndihmuani në këtë aksion të madh e të rëndësishëm. Në fshat ka rreth 80 ha. tokë për taracina. Pa humbur kohë u bë studimi dhe piketimi i taracave. Të parët që ja filluan punës me kazma, qysqi dhe lopata ishin dy brigadat e rinisë: Brigada e Nafize Dushkut dhe ajo e Agim Baçit, me 150 të rinj e të reja. Inisiativën tonë e përkrahën edhe brigadat e tjera të kooperativës, të cilat si dhe ne, pa lënë punët e tjera bujqësore, ndihmojnë në kthimin e shpateve shkëmbore në toka buke. Puna çdo ditë, me gjithë vështirësitë e tokës dhe të natyrës, po ecën mirë. Që prej 4 janarit kur filluam punën e gjer më sot, ne kemi hapur 6,5 ha taraca.

#### 4. Toka e butë

Faqja e malit është e pjerrët dhe e mbuluar me gurë të përhimtë. Gurët janë veshur me një cipë akulli, që shkëlqen nën rrezet e diellit. Nën këta gurë është një tokë e butë dhe e kuqërremtë. Sapo shkulen gurët, ajo lëshon një grahmë të mirë, që ngrihet përpjetë dhe mbush ajrin me aromën e saj. Është erë toke, që për herë të parë

del e ngrohtë në ajrin e pastër, është era e një toke, që ka dremitur ndër shekuj poshtë atyre shkëmbinjve. Jo, mali nuk u rri më njerëzve si përbindësh mbi kokë. Nga gjiri i tij do dalin shiritat e tokës varg e varg si shkallë, shirita toke që do të mbillen me misër. Kjo tokë e malit do të bëhet nënë e mirë për njeriun, kjo tokë do të jepë bukë me bujari.

Qysqia futet në të plasurat e gurëve. Gurët në fillim janë kokëfortë e s'luajnë nga vendi, po pastaj, të bindur nga fuqia e qindra njerëzve të bashkuar, jepen e rruckullisen poshtë, duke nxjerrë tokën e kuqërremetë në dritë. Ajo është tokë e shëndetëshme, tokë që s'i ka dhënë kurrgjë njerëzve, po që tashti do të jepë shumë.

Buzë një rrëpire, ku disa muratorë bëjnë murin e taracave, qëndrojnë në këmbë dy të reja; janë brigadierja Nafize Dushku dhe agronomja Violeta Baçi.

— Si u vete puna? — i pyesim.

— Shumë mirë! — thotë Nafizeja. — Anëtarët e brigadës sime punojnë për mrekulli. Ne e kemi normën të hapim 16 metra katror në ditë, po shumë prej tyre bëjnë nga 20 dhe 25 metra katror në ditë.

— Kush për shembull? — e pyesim ne.

— Ja, — më thotë ajo e tregon me dorë tre të rinj, që sheshojnë një vend.

Ata janë: Miri Dushku, Haki Peshkëpia dhe Beani Adri.

Të tre këta të rinj janë shembull në punë. Sido që të jetë moti, ftohtë, ngricë a erë, ata vazhdimisht e tejkalojnë normën. Miri është një djalë trup vogël, me vullnet të fortë dhe punëtor

i palodhur. Ai punon me ritëm të njëllojtë, rrallë herë e drejton trupin, e ky ritëm pune e lodh atë më pak.

— Po vajzat a mbeten prapa djemve? — pyesim Nafizen.

— Jo — më thotë ajo, — Kemi të reja që punojnë njëlloj me djemtë.

Dhe më tregon për Fetije Çamin, Hyrma Bezatin, Ëngjëllushe Adrin.

Në faqe të malit tashmë duken taracat e para. 6,5 hektarëve, që janë hapur, u shtohen vazhdimit metra të reja taracash. Ato vijnë varg e varg e një ditë do të dalin gjer në krye të fshatit.

Agronomja Violeta Baçi më tregon se taracat do të shtrihen që nga çezma e vogël e gjer mbi Podgori, në një gjatësi afro 1 km.

— A është tokë e shëndoshë kjo? — e pyesim.

— E mirë është, — thotë Violeta, — Ne do ta plehërojmë. Të gjithë të rinxjtë janë zotuar që secili të bjerë për taracat 25 kv. pleh.

— Kemi dëgjuar se keni marrë pleh në stanet me kafshë, — i themi Violetës.

— Po — thotë ajo. — Ne kemi marrë rreth 1000 kv. pleh nga stanet ku veron bagëtia. Atje ka shumë pleh e të rinxjtë janë zotuar që ta marrin e të plehërojnë tokat që do të mbjellim me misër. Siç e shihni, fshati ynë nuk ka asnje copë tokë që të vaditet, prandaj ne i japim shumë rënëndësi plehërimit.

— Po në taraca, a mund të bëhet misri mirë?

— Posi jo, — thotë ajo. — Këto janë toka të shëndosha e ne mendojmë të marrim gjer në 30 kv. për hektar.

Në një vend, pak më tutje, ishin mbledhur shumë njerëz. Atyre u kishte dalë një gur i madh dhe po e thyenin.

— Ka vështirësi shumë kjo punë, —tha një fshatar me një kësulë në majë të kokës.

— E po, po s'i luajte këmbët, s'kanë çfarë hanë dhëmbët, — ja priti një i ri me të qeshur.

Në taraca, punët ishin të ndryshme.

Në një vend sheshonin dhé, në një tjetër bënин mur, diku thyenin gurë e i hiqnin me tezgë, ea mbanin pllaka të mëdha guri dhe i vinin në themel të taracave. Njerëzit lëviznin e punonin në faqet e malit e vazhdimisht dilte ajo tokë e butë, që kundërmonte ajrin e kthjellët.

## 5. Portret

E quajnë Haki Peshkëpia. Është një djale rrreth të njëzetave, me trup të lidhur e fytyrë të mprehtë. Leshrat e shtruara i ka prerë shkurt e ka një vështrim të qetë e dashamirës. Duart i ka të argasura nga puna e këmbët të forta. Të tërhiqte vëmendjen puna e këtij të riu. I ngjitej malit me rrëmbim, shkulte një gur të madh, e ngrinte në sup dhe zbriste me nxitim duke shkelur nëpër thepat e shkëmbinjve. Figura e tij me gurin në sup, kur e shikoje nga poshtë, kish diçka jashtëzakonisht tërheqëse, duke pasur prapa si sfond qielin. Dhe ec e jaket e tij lart e poshtë malit s'kishin mbarim. Fytyra i qe skuqur nga puna, duart i kishte bërë me dhé e merrte frymë me nxitim.

— Ky u lodh e u këput, — i thashë një

fshatari aty pranë. Fshatari tundi kokën, buzëqeshi e tha:

— Ay, a? S'e njihni Hakiun ju? Ehu, e ku të lodhet Hakiu?! Ai është, që si të të them...

I afrohem dhe e pyes. Hakiu turbullohet e flet me një zë të shtruar. Duket që i vjen zor të thotë diçka pér punën e tij.

Hakiu buzëqesh e skuqet më shumë. Fjalët i ka të pakta, i vjen rëndë t'i nxjerrë, si ata gurët që mban në shpinë.

Ai rri pak e pastaj vrapon drejt majës së malit. Merr një plloqë të madhe, e vë në sup dhe zbret po me vrap. E hedh gurin në murin e taracave e niset prapë.

— Ngadalë, mor i uruar, — i thotë ndonjë, po Hakiu s'e dëgjon. Të hapësh taraca duhet punë e madhe e Hakiu përpinqet me të gjitha forcat të japë më shumë në hapjen e kësaj toke të re.

## 6. P u n ë t ë m b a r ë

Ne ikém nga taracat duke u uruar të rinjve e kooperativistëve punë të mbarë. Arat mbetën prapa e që nga larg dëgjonim ende vrullin e punës së tyre. Do të kalojnë pak vjet e mbi Podgori, në shpatet e larta të Malit të Thatë, do të duken brezat e bukura të taracave që do të gjelbërojnë nga misri, nga vreshtat. Dhe shtëpitë e gurta, që i kthejnë shpinën malit, s'do të kenë më atë shprehje mërie që kanë pasur pér këta gurë shterpë. Nga gurët do të dalë toka e kjo tokë, ashtu si fusha, ashtu si ajo nëna e mirë, do të japë bukë. Dhe dimri do të jetë më i butë dhe vera më e

freskët. Kjo, sepse pranë shtëpive, lart, në taraca  
do të rriten pemë, do të shushurijnë fletët.

V. KORESHI

(Zëri i Rinisë, shkurt 1966)

## MAJË DHËMBLANIT NË FURTUNË

Bisedoj me Avni Axhemin. Jemi ulur në majë të një shkëmbi. Poshtë, nën këmbët tonë, rrjedh një përrua i thellë me ujë të kristaltë. Përpara kemi malin e gjerë të Dhëmblanit. Na duket sikur jemi në fundin e një honi gjigand. Mali zbardh nga dëbora. Ai është një mesoburrë me sy bojë qielli. Ka lënë zyrën në Tepelenë dhe ka ardhur këtu, në Sinanaj, të jetojë e të punojë për gjithmonë me fshatarët. Avni Axhemini qëndron pranë meje dhe, me një shkop në dorë, më tregon fshatin në rrëzë të Dhëmblanit. Ai tani është kryetar i lokalitetit në Sinanaj. Ndërsa Avni më tregon, shoku im, një specialist për radio, hyri në klub për t'u ndrequr fshatarëve radion me vajguri.

— Tani djeg dielli, — thotë kryetari i lokalitetit, — por pardje kishte erë dhe furtunë.

— Furtunë?!

— Furtunë që s'të linte të merrje frymë.

Ai heshti pak dhe filloi t'i ngulte sytë te muilliri.

— Pse dole nga shtëpia? — e ngacmova unë.

— Ke të drejtë ti, mor shok. Por njerëzit tani këtu, tek ne, s'kanë nge të theken pranë zjarrit. Duhen mbjellë 15 ha me patate, s'i thonë shaka.

— E ku? Mu në majë të Dhëmblanit, në Eremec, ja, pas asaj qafës me dëborë.

— Po atje s'ka udhë, është rrëpirë. Edhe tokë nuk shoh majë malit.

— Tokë ka, por ka qenë e mbuluar me gurë. Fshatarët e Sinanajt e të Salarisë iu ngjitën malit dhe e bënë shesh. T'S'i thonë shaka: u hapën 15 ha që u mbollën me patate.

— Ti ke hipur atje, i ke parë vetë?

— Vajta pardje. S'kisha ca ditë që kisha ardhur nga Tepelena. Të thashë, bënte furtunë. Vendin nuk e njihja mirë, prandaj mora me vete Reiz Kalon. Ai i njeh këto vende me pëllëinbë. E, që thua ti, muarëm udhën që kthehet për Kurvelesh, dhe që andej nisëm të ngjitemi përpjetë.

— Ku është kjo udhë?

— Nuk duket këtej. Duhet të kapërcesh bregun atje përtëj. Mali aty është brinjë. Unë ecja me Reizin. Era frynte si me ulërima. Mezi i hidhni këmbët. Ecnim pranë e pranë dhe kapeshim me duar e me thonj pas shkëmbinjve. Mirëpo era na përplasej në fytvrë. Ç'të bënim? Mbetëm në vend, në një zgavër.

— E pastaj, u kthyet prapë?

— Ke të drejtë ti! Si mund të ktheheshim prapa kur atje lart, në furtunë, hanin gurin me dhëmbë dy brigada të kooperativës së Salarisë dhe një tjetër e kooperativës së Dhëmblanit?

— Dhe Avniu më vështroi vëngër.

— Mos u habit. Kështu jam habitur edhe unë në fillim kur i pashë për herë të parë njerëzit t'i ngjiteshin malit në palcë të dimrit e kur i pashë duke punuar atje lart. Por edhe unë atëhere via

nga qyteti. Pak e njihnim ne fshatin, o shok...  
Më fal se s'ta di as emrin.

Avni Axhem mori frymë thellë dhe i hodhi  
sytë nga maja e malit me dëborë.

— E pastaj, ç'bëtë pastaj? Ndënjet shumë në  
atë zgavër?

— S'vajtëm për të ndenjur atje, jo. E ndjeva  
trupin të mpirë pas kaq e kaq kohësh dhe, të them  
atë që është, më vinte ca zor nga vetja. Këto anë  
i kisha shkelur kur isha partizan. Mbi dëborë  
kam ecur në atë kohë sa të duash, bile me kë-  
mbët të zbathura. Por ja që trupi më qe mpirë ca.  
Kujtimi i kohëve partizane, i marshimeve parti-  
zane, sikur ma ngrohu gjakun dhe më dha zemër.  
Pastaj ndruhesha ca edhe nga Reizi. Do të thoshte  
pastaj Reizi: «Ja, na erdhi nga qyteti, nga zyra  
dhe tani iu muar fryma!...

Avniu qeshi me gjithë zemër. Qesha edhe unë  
tek po e dëgjoja ashtu i ulur majë shkëmbit. Me-  
njëherë m'u rrit figura e tij para syve të mi.  
«Koha partizane, koha e sotme, — thashë me  
vete. — Ç'forca dhe energji të mëdha ka treguar  
gjithmonë ky populli ynë!» Dhe pastaj, për ta  
shtyrë në bisedë, i thashë prapë:

— Më duket se po e zmadhon këtë punën e  
erës. Kur kështu kjo suferinë e tërbuar? Pa shih  
si të përvëlon dielli...

Avniu qeshi. E kisha lënduar pak.

— Nuk shtova asnjë thërrime. Pyet Reizin,  
pyet fshatarët: ja ku i ke. Këtu moti është me na-  
ze shumë. Sot mban bukur dhe të nesërmend têr-  
bohet. Ja, si pardje. Era frynte me kaq shpejtësi  
e forcë, sa që ne të dy muarëm nga një gur të  
madh në duar për ta rënduar trupin. Por unë

nuk e kam fjalën këtu. Kur të fola për furtunën, unë doja të tē tregoja një gjë tjetër. Doja të tē flisja për njerëzit që punuan atje majë malit, edhe pse bënte ftohtë e frynte suferinë.

Pyeta një grua:

— U lodhët, shoqe?

— Bën pak ftohtë vërtet, por kjo tokë është floriri vetë. Prandaj ta ka ënda të punosh.

Pyes një grua plakë:

— Po ti ç'ke dalë në këtë ditë?

— Pse tē mos dal, kur kanë dalë të gjithë? Pse tē mos punoj, kur jam e zonja? S'më kanë lënë forcat, joo! S'jam nga ato që prehen mbanë oxhakut.

— Por era sot është e tërbuar, moj nënë.

— E kur e kemi pyetur suferinën ne, mor tē keqen. Është vendi i Selam Musait ky vendi ynë.

«Dreqo-plakë, — thashë me vete. — Kjo s'ta bën tē gjatë». Dhe në atë minutë desha t'i përqafja një nga një. Prapë më erdhi turp nga vetja. Unë isha mësuar tē shkoja nga një zyrë në tjetrën dhe tani, papritur e pakujtuar, ndodhesha para një vendosmërie tē rrallë, para një vullneti tē papërkultur, para një entuziazmi tē mrekullueshmëm tē kolektivit në punë.

— I mbuallët dot patatet? — e ndërpresa Avniun.

— Posi! Një pjesë e mbuallëm. Tokën aty e kanë plehëruar shekujt, dhe vendi është i shkri-fët. Do tē mbjellim prapë. Kooperativistët punojnë me vrull, i madh e i vogël. Ajo plaka është 60 vjeç.

— 60 vjeç?!

— Po, po, aq është. Dhe e ka shtëpinë në fund të fshatit.

— Po kur kthehen në fshat, nga ç'udhë kalojnë? Unë shoh që mali mbi shtëpinë e fshatit është thikë.

— E, mor vëlla! Ç'e kujton ti, bulevard? Aty ku ecin dhitë, ecin edhe njerëzit. Ti mbasë ke dëgjuar kur thonë se këtu ha pula strall. Dhe kështu është, këtu ha pula strall.

— Edhe kur ka erë e furtunë atë udhë mbajnë?

— Udhë tjetër s'ka. Mal e rrëpirë. Atë ditë fryu erë gjithë ditën. E sheh atë shkëmbin e bardhë? Që nga shkëmbi e deri poshtë rrëpirë është. Dhe s'janë pak: afro 700 metra rrëpirë me zhavorr. Me të shkelur në zhavorr, rrëshqet këmbla vetvetiu e sa të hapësh e të mbyllësh sytë, gjendesh mu në fund te prallet. Po ditën që zbritëm nga kjo brinjë e thepisur, furtuna bënte kërdinë. Të merrte e të rrukulliste mbi zhavorr.

Unë po shënoja këto fjalë në bllokun tim. Avniu e vuri re dhe sikur nuk i erdhi mirë.

— Ç'shkruan ashtu? Këtu nuk ka asgjë të jashtëzakonëshme. Me këto punë fshatarët merren përditë. Vetëm një gjë ka rëndësi: fshati është zotuar ta sigurojë vetë bukën. Kjo po, këtë mund ta shkruash në bllok dhe pikë.

— Këtë do ta shkruaj, — e sigurova Avninë.

— Po ti ç'mund të më thuash për veten tendë tani që erdhe të jetosh me kooperativistët?

— Them se në fillim m'u duk e vështirë, kurse tani, në do të dish mendimin e zemrës, pas asaj dite me furtunë, jam lidhur më shumë shpirtërisht jo vetëm me njerëzit, por edhe me

malin. Dje dolla këtej poshtë pérroit dhe më erdhë në mënd ideja që, në të ardhmen, të mund të ngremë te mulliri një hidroçentral.

Nga klubi, pranë shkëmbit ku ishim ulur, na erdhë në vesh zhurma e radios.

— Shiko djalli, e rregulloi, — thirri Avniu duke u ngritur në këmbë. — Një vit kishte që po priste e prishur në një qoshe.

Kur hymë në klub, pranë radios me vajguri dhe pranë teknikut që rregullonte valët, fshatarët kishin formuar një gjysmë rrëthi dhe dëgjonin muzikë nga Tirana jonë...

**MIHO GJINI**

(*Zeri i Popullit*, mars 1966)

Arti i kësaj i ri është që nuk e nxitet si një, edhe pse i jepet një çështje nevojsh. Qëllimi i kësaj është që nuk e përfundojë së paktën. Në këtë kohë së paktën nuk ka një vlerësim i madhi që mund t'i bërë këtë. Në këtë kohë, që kemi qëndruar në një çështje të lartë, nuk ka çfarë mund t'i bëj, që nuk ka çfarë mund t'i bëj. Në këtë kohë, që kemi qëndruar në një çështje të lartë, nuk ka çfarë mund t'i bëj, që nuk ka çfarë mund t'i bëj.

Arti i kësaj i ri është që nuk e nxitet si një, edhe pse i jepet një çështje nevojsh. Qëllimi i kësaj është që nuk e përfundojë së paktën. Në këtë kohë së paktën nuk ka një vlerësim i madhi që mund t'i bërë këtë. Në këtë kohë, që kemi qëndruar në një çështje të lartë, nuk ka çfarë mund t'i bëj, që nuk ka çfarë mund t'i bëj. Në këtë kohë, që kemi qëndruar në një çështje të lartë, nuk ka çfarë mund t'i bëj, që nuk ka çfarë mund t'i bëj.

Arti i kësaj i ri është që nuk e nxitet si një, edhe pse i jepet një çështje nevojsh. Qëllimi i kësaj është që nuk e përfundojë së paktën. Në këtë kohë së paktën nuk ka një vlerësim i madhi që mund t'i bërë këtë. Në këtë kohë, që kemi qëndruar në një çështje të lartë, nuk ka çfarë mund t'i bëj, që nuk ka çfarë mund t'i bëj. Në këtë kohë, që kemi qëndruar në një çështje të lartë, nuk ka çfarë mund t'i bëj, që nuk ka çfarë mund t'i bëj.

## KAPITULLI I FUNDIT I NJË HISTORIE

Ai apo ish kthyer nga puna dhe ashtu, i dërsirë, u shtri në krye të arës. Nuk e kish lodhur puna e rëndë e ditës se sa një mendim, i cili kishte ditë që e shqetësonte. Hodhi sytë poshtë dhe pa rrugën që kish bërë derisa erdhi aty. «Paskam ecur për qamet», — tha dhe shikimin e ndali tej arave djerrë, të cilat nxinin, sikur mos kish mbi-rë në to kurrë fije bari. Pastaj përsëri filloi të shqetësohet nga mendimet që i vinin në kokë dhe me to e zuri nata. Kish filluar të frynte një erë e freskët që ja lëmonte fytyrën. Ai lëvizi nga vendi dhe ndjeu se trupi i ishte mpirë dhe djersa i ishte tharë. «Bëka ftohtë», — tha dhe e ngriti kokën drejt qiellit. Yjet ndrinin në kupën e përhime që mbulonte horizontin dhe ai pëshpëriti: «Ishallah bie ndonjë shi». U ngrit pa e ditur sa orë kishte ndenjur aty...

...Vite më parë, një murator shëtitës ngjiste atë të përpjetë që ngjiti ai. Me një mushkë të kuqe, që i shkëlqente qimja dhe me një torbë me vegla, ai e cte për nën katundin e Topojanit në rrithin e Përmetit. Ishte muaji i korrikut dhe arat majtas e djathtas, të çara nga dielli, nxinin ashtu si tashti. Aty këtu ndonjë fshatar kishte mbjellë ndonjë shinik misër, duke e mbajtur kokën drejt qiellit se mos «donte i madhi zot» dhe

hidhte disa pika shiu. Po i madhi zot nuk i kish dëgjuar lutjet dhe misri i fishkur dhe i tharë var-te kokën për një pikë ujë. Mjeshtri ecte hipur në mushkë dhe sytë nuk ja ndante fushës së vogël. Pastaj kaloi nëpër një të përpjetë dhe u ndodh në një përrua. Mushka uli kokën të pinte ujë. Vapa e korrikut të përvëlonente. Ai shikonte lart ujët kristal që zbriste me rrëmbim, dhe mëndjen e kish te fusha e vogël që sapo pat kaluar.

Kur mori të përpjetën, hodhi sytë poshtë. Një shkëmb i thepisur ndante përroin nga fusha e vogël. «Ç'budallenj, — tha, — e kanë ujin në krye të arave dhe nuk dinë». Uji ecte drejt rru-gës së tij shekullore dhe ai drejt fshatit.

Mjeshtrit i dhanë shumë porosira. Dikush donte të rregullonte avllinë, dikush hajatin, një tjetër murin e shtëpisë. Ai bënte pazar, po mendjen e kish gjetkë. Së fundi bisedën e nxori atje ku donte.

— U thanë mirsat, s'po pikon një pikë, i qof-shim falë...

— Sot sikur më kanë dhëmbur kyçet, do të prishet koha.

— Ishallah...

— Ju e mban i kokën përpjetë drejt qiellit dhe harroni se ja ku e kini përroin.

— Ç'e do, është i thellë i uruari. Nuk ka nga hipën ujët.

— Ujët?! — tha mjeshtri. — Nga shkëmbi.

— Mos folë marrëzira.

Muratori u tha atëhere se ai e bënte kanalin. Vitet kaluan dhe kanali përsëri nuk u bë, mbasi mjeshtri u kish kërkuar fshatarëve 50 napolona flori dhe, pasi të conte ujët në fushë, ta

shfrytëzonte atë tre vjet. Fshatarët, ca nga që nuk kishin besim se çuhej shkëmbi e bëhej kanali, ca nga që nuk ja kishin takatin t'i përgjigjeshin pangopësisë së këtij muratori-tregëtar, e lanë përsëri në heshtje...

Ja këto mendonte këtë natë i riu Rustem Tice. Në mëngjes e kish kokën të rëndë. Nuk kishte fjetur fare. U ngrit dhe u nis përsëri për në punë. Rrugës takon një plak nga fshati i tij dhe të dy ecin bri njëri tjetrit. Kur arrijnë te përroi, Rustemi ndalet. Ujët ecte me shpejtësi tatëpjetë.

— Misrat tonë po thahen, — tha.

Po plaku as që i shkoi anës kuptimit të këtyre fjalëve. Pastaj pasi lau e freskoi sytë me ujët e kulluar, tha:

— S'do, i qofshim falë...

— Kush s'do? — tha Rustemi, sikur ta kish fajin plaku për të gjitha ato ç'kish menduar. — Jemi ne budallenj, dembela... Ja ujët, ja arat, ja misrat. Po ne...

— Mos fluturo, mor bir. Nuk je as i pari dhe as i fundit. Kështu desh të bënte edhe, por...

— E di, — i tha ai.

— E di, po nuk e di mirë. Ujët nuk hipën atje. Duhet çarë shkëmbi.

— Atje ta kam, — i tha i riu.

— Je i ri ti, mor bir, nuk i di të gjitha. Ti thua: ç'fluturon hahet. Pastaj ai i tregoi edhe një histori tjetër, kur thuhej se një inxhenjer që kishte kaluar asaj ane, paskësh thënë se hapja e kanalit për të shfrytëzuar ujët e përroit ishte pothuajse e pamundur. Dhe, po që se mund të arrihej një gjë e tillë, kjo do të bëhej me shumë shpenzime.

Këto histori kishin mpirë mendjen e fshatarë-ve pér vite me radhë dhe ishte formuar bindja se një gjë e tillë ishte e pamundur. Bile kush fliste pér këtë gjë, ja mbyllnin gojën menjëherë. Përpara një lufte e këmbëngulje të tillë ndodhej edhe Rustemi. Ai ishte i shqetësuar dhe mendohej se si t'ja fillonte të mposhte mendimin shekullor e pastaj të fillonte hapjen e kanalit.

Atë ditë, në arë bisedoi (ndoshta pér të parën herë) me shokun e tij, Xhezairin. Ai u vu në mendime. Nuk ishte shaka.

- Ta hapim kanalin, — i tha Rustemi.
- Të çajmë shkëmbin? Nuk e di historinë?!.
- Lere historinë, a je dakord me mua?
- Të mendohem.

— Ç'të mendohesh? Fusha çdo vit çahet e plasaritet pér ujë e ne nuk marrim dot një qase misër. — Po thellë në vete ai i jepte të drejtë shokut të tij, i cili kërkonte të mendohej para se të jepte fjalën. Këtë e kish bërë edhe ai vetë, kur i kish ardhur në kokë kjo ide.

Të dy shokët biseduan edhe me dy të rinj të tjerë: Aliun dhe Bilon. Pasi e menduan dhe e peshuan mirë çdo gjë, e diskutuan në organizatën e rinisë. Në fillim mjaft vetë kundërshtuan, por më vonë i përkrahën. Ky qe fillimi.

Historia e kanalit kishte vite që ish harruar dhe asnjeri nuk e zinte më në gojë. Kjo heshtje e gjatë u thye nga të rinjtë. Rustemi herë pas here kalonte nga pérroi, hipte në rrëzë të shkëmbit dhe diçka maste me sy. Ndoshta thellë në ndërgjegjen e tij kishte ndonjë fije mosbesimi. Nuk ishte shaka të përbysje mendimin e të vjetërve. Ndoshta

ata kishin tē drejtë: Shkëmbi mund tē mos çuhej, ujët mund tē mos hipte deri atje. Pastaj...

Ishin ditët, kur fshati diskutonte projekt-direktivat. Kjo gjë tē rinjve u dha zemër edhe më tepër. Në mbledhjen e përgjithëshme tē kooperativës u ngrit Rustemi dhe tha:

— Ne shokë zotohemë tē çajmë shkëmbin e përroit në arat përposh.

Nuk kishte ndodhur ndonjëherë një habi e tillë. Atmosfera e asaj mbledhjeje ishte e jashtë-zakonëshme. «Çiliminj», «të marrë», «fjalë në erë», «s'dinë ç'të flasin», «u bë kungulli tē marrë gardhin» pëshpërisnin disa kooperativistë. Po në qo she tē sallës, ata tē katër që kishin hedhur këtë shkëndijë, heshtnin.

— Pushoni, shokë, ta mendojmë.

— Çfarë tē mendojmë, tē humbim disa dhjetra ditëpune kot.

— Me lejë, shokë, — tha njëri, — ne tē gjithë i dimë historitë e këtij uji.

— Lëri historitë, — tha një tjetër, — ç'do tē thuash?

— Dua tē them që këta nisen nga interesi vettiak.

Edhe këto mendime e diskutime i prisnin tē rinjtë. Ata vendosën tē durojnë çdo fjalë, çdo sulm.

Zhurma vazhdonte. Pastaj përsëri foli njëri nga tē rinjtë.

— Ne do ta marrim këtë punë përsipër dhe mendojmë tē fillojmë nga puna.

Përsëri lëvizje, shqetësimë, dyshime.

— Nuk do tē nxjerrin gjë në shesh.

— Duan ditëpune këta, shokë. Le ta thonë më mirë troç.

Atëhere erdhi një çast që nuk durohej. U ngrit njëri prej të rinxve dhe priti derisa të vendosej qetësia, pastaj tha: «Ne do ta hapim kanalin me forcat tonë, për këtë mos kini dyshim.

Atë natë, në mbledhje propozimin e tyre e përkrahën shumë komunistë dhe anëtarë të kryesisë së kooperativës. Më vonë organizata bazë e partisë dhe kryesia e kooperativës vendosën që të çelë ky kanal me forcat e tyre. Të rinxjtë tanë duhej ta justifikonin me punë këtë besim. Një ditë grupei i të rinxve iu drejtua shkëmbit, me kazma, qysqi e lopata në krahë. Të përcjellë nga ironia therëse e disa fshatarëve, ata morën tatëpjetë dhe e ndalën vrullin rrëzë shkëmbit, pa u bërë merak fare për dyshimet, sulmet e mendimet e disave.

Ditët kalonin dhe ata çanin shkëmbin. Qysqia e vareja hidhnin copat e gurëve e të shkëmbinjve poshtë në përrua. Duhej patur mendja se, nga pakujdesia më e vogël, mund të thyje kokën, një rrëshqitje e këmbës të conte në greminë. Ata ishin të detyruar të punonin në një teren shumë të ngushtë, aq sa mezi vërtitnin kazmat e qysqitë. Loddeshin, po në mbrëmje ktheshin të gjuar. Por ndodhi që një ditë të rinxve u doli një shkëmb i fortë, që nuk e çante as qysqia e nuk e thyente as vareja. Dhanë e dhanë po nuk e thyen. Kërcente kazma mbrapsht e lëshonte xixa. Atëhere ata biseduan me sekretarin e organizatës bazë të partisë.

— Ngecëm, — i thanë, — duam ndihmë.

— Punoni, — u tha ai, — së shpejti do t'ju sjellim ca dinamit.

Ata sikur fluturuan. Kjo donte të thoshte shpëtim nga turpi, donte të thoshte fitore. Di-

namiti erdhi, plasi e shkëmbi i fortë u çà. Pastaj puna vazhdoi si më parë.

Ata punuan deri sa kanali u hap i téri dhe ujët e pérroit mori rrugën e re drejt fushës.

Ato pak misra që ishin mbjellë e prisin tu binte një pikë shi, e ngritën kokën lart e jeshiluan. Tashti në këtë fushë kooperativistët do të mbjellin pa frikë të gjitha bimët që duan ujë. Ujët e pérroit është i mjaftueshëm pér tërë këtë sipërfaqe.

Në vargun e historive të këtij kanali, bashkë me historinë e muratorit — tregëtar dhe historinë e inxhenjerit pesimist, do të tregohet edhe historia e këtyre të rinxve si kapitull i fundit dhe kapitull i fitores tërë kësaj historie.

### XHEVIT ABAZI

(Zëri i Rinisë, gusht 1966)

## RRUGË TË NJOHURA DHE TË PANJOHURA

Brigada që ka marrë 42 kv. misër për hektar.

Kooperativa bujqësore e Shirqit hyn në radhën e ekonomive më të mira të rrëthit. Edhe kur hartoi projektpalin e pesëvjeçarit të katërt ajo u dallua nga fqinjët e saj. Në të gjitha kulturat planifikoi të merrte rendimente më të larta, duke siguruar pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve në punët e kooperativës, duke shtuar vrullin revolucionar dhe iniciativat krijuar, duke zbatuar një sërë masash agroteknike, të cilat dihet që ndikojnë në shtimin e prodhimit. Frymëzuese për të planifikuar rendimente të larta ka qenë sidomos brigada më e dalluar e kooperativës, e cila drejtohet nga Gjelosh Mark Meçaj.

Vitin e kaluar ajo mori mesatarisht 42 kv. misër për ha, ndërsa në 7 hektarë të mbjellë me oxhakë mori 50 kv. për hektar, në lulëdielli mori 20.3 kv. për hektar, kurse në fasule 8.3 kv. për ha. Edhe sivjet parashikon të marrë në misër rendimente të larta, rrëth 45 kv. për hektar. Ky është pikësynimi i brigadës.

— Mos janë më të mira tokat e brigadës që drejton Gjeloshi? — pyes kryetarin e kooperativës.

— Jo. Ato nuk ndryshojnë nga të tjerat. Tokat, p.sh. janë të njëlllojta me ato të brigadës që

drejton Njac Pali, ku janë marrë vitin e kaluar rendimentet më të ulëta. Në misër, p.sh, Njaci mori 21.5 kv. misër për hektar.

— Pse ky ndryshim kaq i theksuar?

— Sepse brigada e Gjeloshit ka punuar më mirë. Puna e keqe e ndonjërit është bërë problem i gjithë anëtarëve, është dënuar nga vetë ata. Për të gjitha masat që ka marrë brigada, është ndjerë fërgjegjësia kolektive. Inisiativat dhe propozimet e ndryshme janë vlerësuar dhe përkrahur nga brigadieri. Kështu p.sh, skuadërkomandanti Mehmet Ymeri ka qenë iniciatori dhe zbatonjësi i mbjelljes së misrit me oxhakë. Edhe për grumbullimin e hirit dhe përdorimin e tij si pleh kanë propozuar vetë anëtarët. Kjo brigadë sivjet grumbullooi 250 kv. hi zjarri, ka kompostuar 50 përqind të pëlhut organik, ka grumbulluar pleh nga oborret e anëtarëve. Fryma revolucionare që ka karakterizuar gjithë brigadën, dhe masat konkrete që ka marrë ajo, janë një bazë e sigurt për të marrë edhe sivjet rendimente të mira, për të siguruar, të paktën, rendimentin e parashikuar prej 45 kv, misër për hektar. Ndryshe ka ndodhur në brigadën që drejton Njaci. Këtu këmbëngulja për të dalë në ballë ka munguar, punët janë zvarritur. Kjo ka sjellë si rrjedhim që plugimet të kryhen në të lagët, prashitet jetë mos bëhen me cilësi të mirë, numri i bimëve për hektar të mos jetë i plotë, etj.

I drejtohem Gjeloshit:

— Megjithëse brigada që drejtoni ju ka marrë rendimente të larta në misër, a mendoni se është bërë gjithçka?

— Jo. Mund të bënim më tepër. Në 7 hektarët, p.sh. ku bëmë mbjelljen me oxhakë dhe morën 50

kv. misër për hektar, mund të kishim marrë edhe 5 kv, për hektar më shumë nëqoftëse do të kishim bërë edhe një prashitje pas vadirjet.

- Po rezerva të tjera mendoni se s'ka?
- Mund të ketë.
- Polenizimin artificial, p.sh, e keni bërë?
- Jo.
- Farë hibride keni përdorur?
- Jo.
- Plehërimin e gjelbër e keni praktikuar?
- Jo.

Ja pra, ç'rezerva ka bujqësia. Edhe atje ku mendon se kanë arritur rendimente rekord, mund të bëhet më shumë.

Po vepron shumë drejt organizata bazë e partisë dhe kryesia e kooperativës së Shirqit, që, me rastin e diskutimit të projektdirektivave të planit të katërt pesëvjeçar, po merr si busull punën dhe rezultatet e brigadës pararojë. Kështu do të zbulohen e planifikohen të gjitha rezervat dhe kooperativa do të ketë një plan me të vërtetë revolucionar.

### Nga shembulli i më të mirëve mësojnë edhe fqinjët

Ngjitur me Shirqin është kooperativa e Dajçit. Të dyja këto ekonomi ndodhen në krahun e majtë të rrjedhjes së Bunës. Përsa i përket tokave, ato ndryshojnë shumë pak. Shirqi i ka diçka më të mira se Dajçi. Por ndryshimi është aq i vogël, sa nuk e vlen të bëhet dallimi siç e bëjnë zakonisht

në Dajç. Të dy kooperativat i kanë tokat të kategorisë së parë e të dytë. Megjithatë, diferencat e deritanishme në prodhim dhe në planifikim kanë qenë të ndryshme. Ndërsa Shirqi, kur hartoj projektplanin, parashikoi që në vitin 1970 të merrte 30 kv misër për hektar, Dajçi 20 kv. për ha.

Por ky parashikim është bërë 8 muaj më parë, atëherë kur në Dajç zotëronte ende konservatorizmi, pasiguria për të bërë një hop të madh. Edhe për rendimentet që u parashikuani ndjehej një farë frike nëse mund të realizoheshin. Nga rrethi u bënë vrejtje dhe u ndihmua organizata bazë e partisë, kryesia dhe gjithë anëtarët për të ndryshuar konceptet e vjetra, për të flakur tej frymën e justifikimit. U bënë diskutime të shumta në organizatën bazë, u bënë kritika e propozime. Puna filloj të organizohej më mirë, frontet e punës u zgjeruan edhe gjatë muajve të dimrit. Brenda një kohe të shkurtër u hapën 20 hektarë toka të reja dhe u kthyen të gjitha këto në taraca. Gati 500 kooperativistë u muarën me këtë aksion për dv muaj rresht. Ky mobilizim i gjithanshëm ngjalli në kuadrot e kooperativës dhe në masën e anëtarëve besimin se, me punë, mund të bëhen çudira. Ata gjatë dy muajve realizuan parashikimin për çeljen e tokave të reja gjatë pesëvjeçarit të katërt.

Por kthesa më e ndjeshme këtu u duk pas konsultës që u organizua në lokalitet për punën dhe rezultatet e brigadës së dalluar të Shirqit. Nën shembullin e kësaj konsulte, në Dajç u organizuan disa konsulta nëpër brigada. Tema e diskutimit ishte «Si të përfitojmë nga brigada e dalluar e kooperativës fqinjë». Pati mendime nga më të ndryshmet: disa thanë të shtojmë edhe ne

numrin e bimëve për hektar, të tjerë vlerësuani plehërimin në fole, të tjerë preqatitjen e tokave. Dhe për çdo masë agroteknike përfitimi u llogarit me laps në dorë. U forcua edhe më shumë besimi se mund të merren rendimente më të larta në misër e kultura të tjera. Po ku t'i gjenin aq forca sa të mbillnin dhjetra hektarë misër me shatë? Bujqësia në atë kohë kishte edhe shumë punë të tjera. «Të vemë në mbjelljet e misrit forcat që na kanë ardhur për ndihmë nga qyteti», propozoi një kooperativist. Mendimi ishte shumë i drejtë. Qytetarët mund ta kryenin pa vështirësi këtë proces pune. Kështu u arrit që kooperativa të mbjellë 45 hektarë misër me shatë, duke hedhur plehun në çdo oxhak. Tani misri i Dajçit është shumë i mirë dhe i janë bërë dy prashitje. Nga 16.3 kv për ha që ishte planifikuar, parashikojnë të marrin 20 kv. për ha.

Kjo kthesë e ndjeshme filloi të thyente edhe konservatorizmin që vihej re në planifikim. U pa e mundur të merrej më shumë nga sa ishte parashikuar kur u hartua projektplani. Me një atmosferë të tillë e gjeti këtë kooperativë botimi i projekte-direktivave të planit të katërt pesëvjeçar. Tani po diskutojnë si t'i rritin shifrat dhe si t'i afrohen kooperativës së Shirqit. Një brigadë e Dajçit ka hyrë edhe në garë me brigadën e Gjeloshit.

Në një bisedë që patëm me kryetarin e kooperativës dhe sekretarin e organizatës bazë të partisë, ata thanë se në vitin 1970 mund të marrin 27-28 kv. misër për hektar nga 20 kuintalë që kishin parashikuar 8 muaj më parë.

Ky është një kapërcim me kurajo, i mbështet-



## UJET E MALEVE RRJEDH NËPËR FUSHA

Një ose dy vjet më parë, kooperativistëve të Grumirës nuk u shkonte mendja që në stinën e vjeshtës ose të dimrit të punonin për vaditjen. Sivjet luftën kundër thatësirës ata e filluan në dimër.

Si ndodhi kjo?

Thirrja e partisë dhe e qeverisë për diskutimin dhe hartimin e planit të katërt pesëvjeçar u hapi horizonte të gjëra anëtarëve të kësaj kooperative. Në atë kohë, në Grumirë u bënë propozime të shumta dhe lindën plot iniciativa nga vetë kooperativistët, të cilët u zotuan të ngrejnë rendimentet e duhanit, misrit grurit dhe bimëve të tjera.

Çfarë bënë kooperativistët e Grumirës? Ata shtuan sasinë e plehut organik dhe të fekaleve në 17 000 kv, mbrojtën të lashtat nga lagëslitura, bënë qilizmë dhe po mbjellin në kushte të mira agroteknike. Këto masa pa tjetër ndikojnë në shtimin e prodhimit. Por eksperiencia shumëvjeçare u ka treguar anëtarëve të kësaj kooperative se, për zonën e Mbishkodrës, thatësira është armiku kryesor i biinëve. Sado përpjekje që të bëjnë ata për mbjellen e shpejtë të duhanit apo të misrit, asgjë nuk e zëvendëson vaditjen, sepse tokat e kësaj zone janë të lehta, ranore dhe kanë nevojë të madhe për vaditje.

Vitin e kaluar kjo kooperativë vaditi me anë të rezervuarit dhe burimeve të tjera vetëm 150 ha tokë. Tokat e vaditëshme u dhanë rendimente të larta. Pra, ujitja është një rezervë e madhe në bujqësi.

Për këtë rezervë kaq të çmueshme u bënë shumë diskutime dhe propozime gjatë punimit të Thirrjes së Komitetit Qëndror të Partisë dhe qeverisë. Ato ditë që punohej Thirrja, kooperativisti Ismail Rustemi tha:

— Para ca vjetësh, fshatarët e lagjes Shpellëzaj kanë vaditur tokat e tyre me një vadë uji që e merrnin nga malet. Tani ky ujë nuk përdoret më. Brigada jonë e merr ujin për vaditjen e rasateve dhe mbjelljen e tyre nga Kroni i Kurtës. Për marrjen e ujit nga kjo largësi ne mobilizojmë njëzet përqind të krahëve të punës. Kjo shton shpenzimet e prodhimit dhe ul vlerën e ditës së punës. Unë jam i mendimit që ta studojmë këtë çështje dhe të hapim kanalin Shpellëzaj-Kurtaj, sepse do të na vlejë shumë.

Propozimi i Ismailit u aprovua njëzëri nga kooperativistët dhe kryesia e kooperativës filloj menjëherë zbatimin e tij. Pjesëtarët e brigadës së Kurtajve filluan punën.

Hapja e kanalit nuk ishte gjë e lehtë. Duhej luftuar me shkëmbinjtë, me pjerrësitë dhe me pengesat e tjera natyrore. Pati kooperativistë që thoshin: «Ç'na duhet ky kanal? Mirë e kemi Kronin e Kurtës. Është pak larg, por nuk lodhemi kështu». Por këta ishin të pakët. Shumica e anëtarëve të kësaj brigade nuk u përkulën përpëra vështirësive, por iu qepën malit dhe e çuan punën deri në fund. Ata vërtet luftuan me shkëmbin, por fituan. Më

15 mars, uji i maleve filloi të gurgullojë nëpër fushë. Tani rasatet e duhanit të kësaj kooperative vaditen jo me krahë, por me ujin e kanalit të ri. Me këtë ujë do të vaditen këtë vit pesëmbëdhjetë hektarë tokë e mbjellë me duhan.

### Nga burimet e Riollit...

Më 23 mars, kooperativistët e sektorit të Lijnajve të kooperativës së Grumirës ishin në festë. Fëmijtë rendnin të gëzuar nëpër fshat dhe thërrisin me zë të lartë:

— Erdhi uji, erdhi uji!

Nga erdhi ky ujë që gurgullon sot nëpër fushë?

— Në malet e Riollit, që zbardhin ende nga dëbora, ka burime me ujë të ftohtë akull, që nuk shterin as në verë. Në kooperativën bujqësore të Grumirës kishte vite me radhë që diskutohej për këto burime. Kooperativistët flisnin shpesh për to. «Ujët e burimeve të Riollit është flori, — thoshin ata. — Por është larg dhe nuk e sjellim dot».

Dy-tre vjet më parë, anëtarëve të kësaj kooperative u dukej si ëndërr t'i sillnin këto ujra poshtë në fushë. «Është e pamundur, — thoshin shumica e tyre. — Ku çahet mali i Riollit me kazma! Do punë të madhe ky kanal. Edhe shpenzime duhen shumë». Dhe kështu, vitet iknин njëri pas tjetrit dhe asgjë s'bëhej.

Por, gjatë vjeshtës dhe dimrit të kaluar, kooperativistët e Grumirës ndërruan mendje. Ata dëgjonin dhe shikonin se, në Vrith, Mqedë, Grizhë, në Breg të Lumit dhe në kooperativa të tjera të rrethit të Shkodrës, hapeshin taraca shkëmbore

për shtimin e fondit të tokës arë. Kudo kooperativistët luftonin me malet dhe delnin fitimtarë.

Në këtë kohë, në Grumirë filluan të dëgjohen këto fjalë: «Po ne çfarë presim? Pse trembemi nga vështirësitë? Mos vallë do të vinë të tjerë të na hapin kanalin e të sjellin ujin e Riollit në tokat tona? O burra t'i ngjitemi malit dhe të ndeshemi me shkëmbinjtë!»

Dhe ashtu bënë. Burrat dhe gratë e njëmbëdhjetë brigadave të kooperativës së Grumirës rrëmbyen kazmat, lopatat, qysqitë dhe iu qepën maleve. Në shkëmbinjtë e thepisur të Riollit u prish qetësia shekullore. Aty, ku më parë fluturonin shqiponjat, u ngjitën djemtë e shkathtë të Grumirës.

Kanali vaditës i Gur-Kurtaj-Riollit është tetë kilometra i gjatë.

Dhe ja, pas tre-katër muajve punë kanali mbaroi, uji i maleve të Riollit erdhi në Linaj. Pas ca ditësh ky ujë do të shkojë edhe në sektorë të tjerë. Hapja e kanalit të Riollit u bë në teren të vështirë. Por ky ishte mësim i madh për kooperativistët e Grumirës. Ata u bindën edhe një herë se po të ketë unitet dhe vullnet, çdo gjë kapërcehet. Në kooperativë flasin me respekt për pjesëtarët e brigadës së sektorit të Linajve me brigadier Zenel Ucin, për ata të brigadës që drejton Mehment Ademi, dhe për kooperativistët e brigadave të tjera, që nuk u përkulën nga vështirësitë, por i kapërcyen ato me sukses.

Me ujin e burimeve të Riollit, verën që vjen do të vaditen dy herë 200 ha tokë. Më 23 mars filloi vaditja e rasateve të duhanit. Ky kanal do të përdoret edhe për mbushjen e rezervuarit të Grumirës.

## Gryka gjëmon nga minat

Duke udhëtarar nëpër grykën e Kok-Papajt, udhëtarët shikojnë lëvizje të madhe. Herë pas here në këto gryka gjëmojnë minat. Re të verdha pluhuri ngrihen përpjetë.

— Po hapim kanal, — thonë vendasit.

Grumirasit po çajnë malin.

Edhe në Kok-Papaj po punohet për vadirjen. Kooperativistët e Grumirës muarën kurajo nga hapja e kanaleve të tjerë dhe disa kohë më parë i hynë më guxim edhe një aksioni tjetër, po aq të vështirë.

Në Kok-Papaj po ndërtohet një kanal gati katër kilometra i gjatë. Si lindi ideja për hapjen e tij?

Disa anëtarë të kësaj kooperative kishin vënë re se uji që filtronte nën digën e kanalit të Reçit, vite me radhë, shkonte kot. Kur u hartua plani i katërt pesëvjeçar, po këta kooperativistë duallën me këtë propozim: «Të hapim një kanal dhe t'i mbledhëm këto ujra. Mëkatë të shkojnë dëm! Do të vaditim disa hektarë tokë. Nuk kemi asnje humbje, veç fitim do të na sjellin». Disa e aprojuan këtë propozim, të tjerë jo. Pati kooperativistë që thoshin: «Nuk e vlen barra qeranë të mbledhësh ujrat e kanalit të Reçit. Do të humbin rrugës».

Megjithatë puna filloj. Edhe këtu, ashtu si në malet e Riollit, duallën vështirësi të mëdha. Toka ku pëershkon kanali është shkëmbore, e thepisur. Të rintjtë e skuadrës që drejton Xhelil Mehmeti i shikon shpesh të lidhur me litar që hapin vrimat dhe vendosin dinamitin.

Shkëmbinj të tërë hidhen në erë nga forca

e të rinjve dhe e kooperativistëve të tjerë. Në këtë kanal punojnë çdo ditë mbi 150 anëtarë të kësaj kooperative. Deri tanë ata kanë bërë mbi 75 përqind të volumit të punës.

Pjesa e dheut është gërmuar e gjitha dhe po vazhdon puna në pjesën shkëmbore. Nga mesi i prillit parashikohet që uji i këtij kanali të gurgullojë nëpër arat e kooperativës.

### Zbulojnë rezerva të tjera

Çel Istrefin, kryetar i kooperativës bujqësore të Grumirës, e gjetëm në fushë. Ai kishte qëndruar në ledhin e një kanali buzë rrugës e diç po mendohet.

Cfarë e çqetësonte Çelën?

Kryetari u takua këtu me dy specialistë të drejtorisë së ujërave të Shkodrës. Midis tyre u bë kjo bisedë:

— Unë jam plotësish dakord, — u thoshte Çela, — të hapim kanalin me forcat tona. Nga shteti nuk duam asgjë. Vetëm piketimin na bëni ju.

— Kur dëshiron të dërgojmë teknikët për të bërë piketimin? — i thanë specialistët e drejtorisë së ujërave.

— Që nesër.

Të dy palët ranë në marrëveshje që të nesërmën të fillonin punimet për hapjen e një kanali vaditës 800 metra të gjatë...

**JANI TOÇKA**

(*Zëri i Popullit, prill 1966*)

## NJERIU MPOSHT NATYRËN

I rreptë duket shkëmbi. Të fortë janë ushtarët. Shkëmbi dhe ushtari që ngjitej e zbriste nëpër-mjet litarit të hollë sa gishti, ende nuk më hiqen nga mendja. Kalitja politike, fizike dhe ushtara-ke, sjellin tek ushtari trimërinë, guximin, qën-drueshërinë që duhen për të mposhtur vështirësitë.

Shkëmbi është i thepisur dhe i lartë. Trupave u shpiegohet detyra qartë dhe politiksht: në çdo pëllëmbë tokë, ku vepron efektivi ynë, duhet përvetesar taktika e stëvitjes për luftë në mal e shkrep, në fushë e lumë, natën e ditën, në çdo ko-hë.

Shpejtësia, siguria e ngjitjes në shkëmb dhe e zbritjes të mahnit. I pari, si zakonisht, jep she-mbullin komandanti. Ushtarët qindfishojnë guxi-min dhe besimin në forcat e tyre.

Ushtarakët po japin shembuj të mrekullue-shëm, që tregojnë se njeriu e mposht natyrën e ashpër dhe të egër kur, mbi çdo gjë, vihet interesi i përgjithshëm. Tani i shoh ata në stërvitje, në detyrën e tyre të parë e numër një të mbrojtjes së Atdheut.

— Partia, — tha ushtaraku Fadil Sokoli, — na ndihmoi që ta zbërthejmë më mirë këtë detyrë. Dhe efektivi ynë, i udhëhequr nga organizata-bazë, vendosi që brenda vitit të parë të 5-vjeçarit

të plotësojë nevojat e veta me bukë, perime dhe patate.

Tani, kur i shoh ushtarët tek ngjiten e zbresin nëpër shkëmbinjtë e ashpër, kuqtoj madhështinë e fjalëve të Fadilit. Ku e gjetën kohën këta ushtarëtë të mësojnë për kalitjen ideologjike dhe politike, të stërviten e të prodhojnë drithë?

— Te vullneti i ushtarëve, — përgjigjet komandanti i repartit. Është gjë e mrekullueshme. Reparti e siguron bukën vetë. Kjo tregon për ndërgjegjen e lartë të ushtarit tonë, i cili, si bir besinik i partisë dhe popullit, gjen vullnet e kohë për të punuar e prodhuar, që ta bëjë ushtrinë më pak të kushtueshme. Ai është i ndërgjegjshëm dhe i bindur nga ana politike se në këtë mënyrë forcon atdheun.

Ushtarakët e repartit 3000 e fituan tokën pasi mundën shkëmbinjtë. Askush nuk u tregoi atyre livadhe e fusha. Ata i hapën arat midis maleve të rreptë e të lartë. Atë tokë që quhej e braktisur, ushtari e ktheu në arë të sheshtë, ku gjelbëron gruri, thekra, elbi e patatja. Vullneti i çelniktë i ushtarit është bërë një model, nga i cili mund të mëscjnë të gjithë.

Gëzohesh pa kufi, kur sheh se ushtria nuk është vetëm shkollë stërvitjeje të gjithanëshme, por dhe shkollë e madhe prodhimi.

Në janar, kur binte déborë, isha në repart. Atëherë i pashë ushtarët si punonin për të kthyer çdo pëllëmbë tokë në shërbim të tyre. Dhe nuk kaloi shumë kohë e kodra u gjelbërua nga gruri i shëndetshëm, patatja dhe perimet. Edhe shpati i një rezervuari aty pranë jeshilon nga patatja.

Të gjitha nënrepartet i kanë plotësuar dety-

rat ekonomike. Fakti që shokët e këtij reparti, që vepron në teren malor, gjetën toka, punuan dhe i mbollën ato dhe janë zotuar që të sigurojnë bukën, tregon edhe një herë se bujqësia ka rezerva të shumta e të mëdha. Kjo e bën shumë të kuptueshme drejtësinë e madhe të parullës së partisë, që na porosit të punojmë me temp ushtarak, disiplinë ushtarake dhe organizim të përsosur.

Komandanti i nënrepartit «N», Bedri Berdisa, tregon: «Detyra për sigurimin e bukës me forcat tona është kuptuar thellë. Reparti ynë do të bëhet edhe më i fortë kur të prodhojë bukën. Ky problem u shtrua në organizatën-bazë të partisë dhe në kolektiv. Këshilli ekonomik i repartit dhe i nënreparteve dëgjoi me kujdes vrejtjet dhe propozimet e ushtarëve. Kështu lindën aksionet vullnetare të ushtarëve, të cilët, pa cënuar aspak rregullin, shërbimin dhe stërvitjen, gjenin kohë të punonin. Ata punuan sepse e kuptuan këtë si detyrë të madhe politike. Ushtarakët, punuan pa lodhje dhe ankesa. Çdo gjë ata e gjetën vetë: tokën, veglat e punës, plehun, librat. Tokat, shpatet e brinjët që s'kanë njohur belin e kazmën u bënë fusha të provës së forcës e organizimit të përsosur».

— Ushtarët mësuan vetë si të punonin tokën e si të mbjellin. Ne nuk patëm agronomë. Agromoni ynë qe libri, revista e vullneti për të mësuar, — thotë ushtari shembullor Th. Vrami, — dhe ne e mësuam për bukuri punën tonë të re.

Ja një shembull tjetër i shkëlqyer, që tregon se, kur një kolektiv mbështetet në forcat e veta dje i përdor ato drejt, mund të korrë fitore.

Bimët e repartit po zhvillohen mirë e bukur. Tani ushtarët po u kryejnë atyre shërbimet kul-

turale, prashitjen dhe mbrojtjen nga dëmtonjësit. E kush ngrihet në orën kâtër të mëngjesit për të bërë spërkatjen kundër buburecit të patates? Ushtarakët. Ata i shtyn vendosmëria për të marrë me çdo kusht prodhimin. Ata nuk presin t'u japë natyra vetë, por përpiken t'ja rrëmbejnë asaj drithin, pataten, perimet. Ky është një qëllim i madh, që ka hyrë thellë në jetën e përditëshme, në shpirtin e çdo ushtari. Kur mendon se të gjitha tokat që ka mbjellë reparti janë pa ujë, atëhere del më në pah vendosmëria për t'i mundur vështirësitë me çdo kusht dhe të merret prodhimi i parashikuar. Puna e bërë deri tanë, zhvillimi i bimëve, tregon se rendimentet do të tejkalojen në të gjitha kulturat dhe parcelat.

— Ne synojmë, — na tregoi komandanti i repartit, — që të prepatemi jo vetëm si ushtarakë shembullorë të Republikës, po edhe si bujq shembullorë. Ushtari që jeton, mëson e stërvitet në repartin tonë, brumoset me kulturë të gjërë politike, ushtarake, fizike dhe organizative për çdo punë, për sot dhe për nesër, për vete dhe për të tjera. Reparti është një shkollë e madhe, ku prepatiten qytetarë besnikë dhe të aftë për mbrojtje dhe për punë.

Ky është një synim i mrekullueshëm, i cili i kalon shumë kufitë e repartit dhe të detyrës së përditëshme. Detyra të tillë i vë vetes vetëm ushtria jonë popullore, e cila ruan e kalit vetitë më të mira të popullit që e lindi dhe e rriti. Kjo është përgjigja më e mirë që ata i japid Letrës së hapur të partisë.

OSMAN ALLKJA

(*Zëri i Popullit, qershori 1966*)

## «DUKAGJINAS NGJITU MALIT»

Kapërcyem një luginë plot shkëmbinj, ku gjarpëron lumi i Shalës me atë ujë të kthjellë e të ftohtë si bora shekullore e Jezercës dhe e Radohimës, mbushur me trofta, me atë lloj peshku, që rritet vetëm në ujrat e rrëmbyera malore. Kemi kohë që ecim e megjithatë parcelat e reja s'po dukeshin.

— Edhe pak na ka mbet, — foli Nikë Toma, kryetar i kooperativës bujqësore, një malësor trup gjatë dhe plot humor. — Ja aty në kthesë ndodhen parcelat. Shihni si gjelbërojnë lulet e patateve.

Djersa na rridhte çurkë. Shtëpitë e fshatit nuk dukeshin më, me përjashtim të ndonjërës që zbardhëllente në gji të malit.

Nika na tregon: «E pra shokë, këtë rrugë të lodhëshme e bajshin kooperativistët nga dy herë çdo ditë. Dilnin që me natë në këtë vënd. Punonin e djersishin, megjithëse temperatura ishte e ulët dhe gjithshka ishte e mbulueme nga bora. Kur ktheheshin vonë natën në shtëpia, në këto gryka. dëgjohej vetëm ulurima e ujqërve të uritur që kërkonin gjahun e strukun në ndonji shpellë.

Arritëm në atë kthesë që na tregoi pak më parë Nika. Përpara nesh u shpalosën parcelat e tokave të reja. Qëndruam të pushonim dhe sytë

nuk ja ndanim asaj toke të re në formë taracash të mbjella me patate.

Tokë në mes të shkëmbinjve. Patate rrënjet e tē cilave shkojnë thellë gjer në damarët e shkëmbit! Kolë Marku, brigadier i brigadës së dytë, që na shoqëronte së bashku me Nikë Tomën, u shpreh shumë bukur:

— Bukë në mes të shkëmbinjve!

Dhe një nga malësorët ja nisi lehtas nji kënge, që kohë më parë dëgjohej shumë në këto anë:

*Dukagjinás zbrit nga mali  
Merre tokén që ta fali  
Sot e bardha ty Parti...*

— Para disa vitesh, me këte kangë luftuem tē bindnim malësorët tanë pér tē lanë këto shkrepë në zemër tē maleve, pér tē zbritë poshtë në fushat e gjana, atje ku kënetat ishin tha, ku pyjet dhe djerrinat ishin kthyen në toka buke. Këto toka u a jepte dhuratë partia malësorëve pa tokë ose me pak tokë, — tregon Nika, — por tani këndohet nji kangë tjetër: «Dukagjinás ngjitu malit». Kështu na mëson sot partia e na i jena qepë malit me gjithë fuqitë tona. Tashti kanga «Dukagjinás ngjitu malit» do tē jehojë këtyne grykave ma e fortë pér ta kthyen edhe shkambin në tokë buke!

Nika shpreh mendime tē qarta dhe tē drejta. Ai na e mbush mëndjen pér sa na thotë. Pak më vonë Nika na tregoi se si u përhap n'ato male fjalë e Partisë pér tē ndërtuar socializmin duke u mbështetur kryesisht në forcat tona. E malësorët me atë vrullin patriotik që i karakterizon, duke mbajtur në një dorë kazmën dhe në tjetrën pu-

shkën, iu përveshën pünës pér të siguruar bukën në krahinën e tyre, me vetë forcat e tyre.

Në Theth nuk u bë mbledhje me kooperativistët, por u bisedua me ta në grupe, nëpër shtëpitë e tyre gjatë mbrëmjeve të dimrit. Vendin e lodrave të gjata e zunë bisedat interesante. Biseda pér bukën, pér këtë problem të madh kombëtar, zinte vendin kryesor. «A asht e mundun që çdo kooperativë, çdo ekonomi të sigurojë vetë bukën me forcat e saj?». Ky ishte problemi kyç rreth të cilit bisedonin njerëzit e çfaqnin mendimet e tyre. Pastaj problemi analizohej në mënyrë të veçantë. «A do mundena na thethiotët ta sigurojmë një herë e përgjithmonë bukën?». Mendimet ishin shumë të nevojëshme pasi së shpejti do të bëhej mbledhja e përgjithëshme e kooperativistëve pér të aprovuar projekt-planin e psëvjeçarit të katërt. Kryesorja ishte që në këtë mbledhje të zotronte mendimi optimist dhe revolucionar se thethiotët jo vetëm do të siguronin bukën e tyre, por në të arthmen t'i shisnin shtetit edhe tepricat. Duhesh mposhtur ndonjë paragjykim ose ndonjë mendim pesimist, si:

— Shkambinjt nuk shtrydhen, nuk bluhën e e bahan bukë.

Kooperativistëve duhej t'u bëhej e qartë se përvëç luftës pér t'i rrëmbyer natyrës atë që nuk ta fal me bujari, në kooperativë ka edhe rezerva të mëdha pér shtimin e drithrave. Mjafton me këtë rast të përgjithësohej shembulli i Kolë Milanit, brigadier i brigadës së tretë që vjet mori 31 kv. misër pér hektar pér të shtuar në mënyrë të dukëshme prodhimin e drithrave të bukës.

Mbledhja e përgjithëshme u bë pas disa ditësh. Aty u fol shumë për sigurimin e bukës. Shokët e brigadës së tretë treguan se si ata kishin arritur të merrnin rendimente të larta në misër. Shumë kooperativistë çfaqnin mendimin se si mund të shtohet sipërfaqja e tokave arë. Njeri tha se disa livadhe mund të ktheheshin në toka buke. Por nga të gjithë u shpreh mendimi se rezervat më të mëdha ishin kodrat, faqet e maleve. «Ti kthejmë kodrat në taraca, në toka buke». Kështu u vendos.

Në mbledhje sundoi ai optimizëm revolucionar për të cilin kishin punuar aq shumë komunistët. Tashti duhej që fjalët të ktheheshin në vepra, të fillohej menjëherë nga puna për ndërtimin e taracave. Por koha ishte e keqe, me ngrica. Bile bora në vendet ku do fillonte puna për taracimin ishte një metër e thellë. Në këto kushte dukej si e pamundur të dilnje përjashta e të luftonje me borën, me të ftohtin e madh. Dikush tha se «po rrjeh ujë në havan se në këtë kohë asgja s'mund të bahej». Kundër këtij mendimi disa shokë hodhën parrullën: «A ka kala që s'marrin komunistët?»

Komunistët qenë të parët që thanë:

— Ta heqim borën. Të ndërtojmë sana rrëshqitëse e me to të sjellim gurë nga mali për tarracat. Koha nuk pret, të fillojmë që nesër!

Dhe të nesërmen brigadat e kooperativistëve të Thethit me kazma, lopata e leva hekuri në duar u ngjitën në kodra e gërxhe për të hapur toka të reja. Hiq borë, thyej shkëmbinj e hap toka. Puna ishte e vështirë, por vetëm duke kapërcyer këto vështirësi mund të arrihej qëllimi që ata i kishin vënë vetes për të siguruar drithrat e bukës që kë-

të vit. Pastaj a nuk kishin hedhur edhe parullën që «A ka kala që s'marrin komunistët?».

Muajt shkurt e mars u bënë muaj sulmi për hapjen e parcelave të reja. Kooperativistët duke ritur vrullin në punë, nga dita në ditë, një copë këtu, një copë atje i shtuan fondit të tokës arë edhe 22 hektar të tjerë. Ata bënë më shumë se 9000 ditë pune në këtë aksion. 9000 ditë pune në një kohë, kur zakonisht në malësi rrihej në shtëpi, pa punë duke pritur shkrirjen e dëborës.

Këto na tregoi Nika tek qëndronim duke puhuar.

— Hapja e tokave të reja vazhdoi ai — për ne pati një rëndësi shumë të madhe. Hapja e saj përforcoi besimin se edhe në një zonë malore, si kjo e jona, njerëzit mund dhe duhet të mbështeten në forcat e veta. Tek malësorët tanë asht krijue bindja se ç'thotë partia asht plotësisht e mundëshme të bahet, se njeriu asht gjithshka, se ai asht bille ma i fortë se hekuri.

Ngrihemi. Bëjmë ca udhë atyre monopateve gjersa arrijmë te tokat e reja që u hapën këtë dimër. Të shtatë hektarët këtu janë mbjellur me patate. Bimët kanë mbirë dhe janë zhvilluar për bukuri. Tek shohim këto toka të reja mëndja na shkon pa dashur n'ato përfundime të shkëlqyera që dha puna dhe mendimi revolucionar, te fjala që ndezi Partia. Pa dyshim këto simbolizojnë forcën e pamposhtur të njeriut tonë që gjithmonë del triumfues mbi natyrën.

Pasi të kalojnë disa javë kooperativistët e Thethit do të ngjiten me thasë bosh në këto toka shkëmbore e do t'i mbushin plot me patate. Ata janë zotuar që nga 80 kv. për ha. që është plani të

marrin 130 kv. Ky zotim nuk është marrë ashtu në tym, por bazuar në punën dhe shërbimet e mira që i janë kryer dhe po i kryhen. Por kryesorja është se me drithin dhe patatet që do të prodhojnë këtë vit kooperativistët e Thethit nuk do të kenë më nevojë të trokasin në dyert e shtetit.

Ky është vetëm fillimi. Kyçi i zgjidhjes së problemit të drithrave të bukës u gjet. Por ata mendojnë që të ecin përpara, të rrisin rendimentet, të shtojnë prodhimet që edhe këtu në malet e larta të sigurojnë jo vetëm bukën, por të kenë edhe rezervat e nevojëshme.

## 2

Ngjitemi më lart. Ecim drejt grykave, luginave dhe kreshtave të maleve madhështore të veriut, me majë kryethinjura, ku vetëm alpinistët kanë shkelur. Natyrë e ashpër, por e bukur. I tillë është Dukagjini. E tillë është gjithë krahina e Shalës dhe e Shoshit, e Nikajve dhe Merturit.

Dhe në çdo hap që bëjmë, në çdo skaj që shkojmë shohim se punohet me parrullën e partisë: «Të ndërtojmë socializmin, duke u mbështetur kryesisht në forcat tona». Edhe këndej me gjithëse shtëpitë janë larg nga njëra tjetra me orë të tëra, të ndara nga faqe malesh dhe kodra shkembore, ndihet pulsi i jetës së re. Malësorët e këtyre anëve i kanë vënë vetes detyrë që çdo ekonomi të sigurojë vetë bukën për nevojat e veta. Kjo është shumë e rëndësishme dhe e dobishtme për ekonominë tonë të përbashkët. Në këto vënde për arësyte të kushteve natyrore nuk janë

krijuar ende mundësitë e ngritjes së kooperativave bujqësore, sepse siç thonë këndeja, këtu çdo shtëpi ka vetëm «nji lamë tokë». Por megjithatë kjo gjëndje është e përkohëshme, sepse njerëzit e këtyre maleve kanë përveshur llërët e po bëjnë të gjitha përpjekjet për të shtuar sipërfaqen e tokës atje ku është e mundur. Edhe këndeja malësorët po luftojnë me malin, me shkembinjt duke flakur tej ndonjë mendim të mykur si «kaq tokë na dha zoti e atij s'mund t'ja marrim me zor». Kudo sheh të hapen tokë të reja për drithra buke. Malësorët tërë gaz e frymëzim punojnë me optimizëm e me besim të math në suksesin e punës që kanë nisur.

Në Lekaj njohëm një malësore të ve, Palina Prek Mehmetin, një grua ende të re në moshë, nënë e tre fëmijëve. E gjetëm atë duke punuar bashkë me dy fëmijët e saj më të rritur Tonen dhe Ndoun. Po prashitnin misrin. Palina me shat' dhe dy fëmijët 10 e 11 vjeçar hiqnin bimët e te-përtëta dhe fletët e këputura.

— Si je, moj motër? —  
— S'kam kenë kurrë ma mirë, — u përgjegj ajo.

E pyetëm në se arrin të marrë nga toka gjithë drithin e nevojshëm për të siguruar bukën e vitit. Sytë i shkelqyen nga një gëzim i mbrëndëshëm. Mendoi pak dhe foli:

— Jo bukën e vitit s'e kam sigurue asnjiherë sa të plotësoj nevojat e familjes. Gjithmonë kam trokitë në dyert e pushtetit. Dhe pushteti asnjiherë nuk më la pa bukë. Por Partia na i hapi sytë edhe na malësorëve. Tash e tutje kam shpresë se bu-

kën e vtit kam me e sigurue. Kjo asht detyra që i kam vue vetes.

Dy fëmijët, vëlla e motër, na shikojnë sikur dëshirojnë të tregojnë se edhe ata e kanë kup-tuar parrullën e partisë pér drithrat e bukës, sikur duan të na thonë:

— Ja edhe ne po ndihmojmë.

Para tri vjetësh, kur i vdiq i shoqi, Palinës i shkuant miq e shokë dhe i premtuan se nuk do ta linin të vuante, se toka nuk do të mbetej pa punuar dhe fëmijët nuk do t'i hiqnin të zitë e ullirit. Malësorja i falenderoi ata, por me mëndje bluante: «A duhet t'ja lejoj vetes që të shpresoj në ndihmën e të tjerëve, në fund të fundit pse të punojnë të tjerët pér mue? Unë jam e fortë. Mir a keq do të dij të punojë tokën, të mbjellë dhe të korr. Mandej edhe fëmijët po rriten. Do të më ndihmojnë. Dikush do ta quaj turp këtë që mendoj unë. Turp! E pse të jetë turp? Dikush do të thotë se «gratë tonë nuk e kanë zakon të punojnë tokat, ti si do ta prishësh këtë zakon?» Si do të përgjigjem në këtë rast? Këtij «dikujt» do ti them se asht ma mirë të jetoj me nder, me djersën e me mundin tem, se sa të rri në mëshirën e të tjerëve. Kjo asht rruga më e ndershme. Ata, që kanë dëshirë le të flasin. Atij që do më shtrijë dorën vllazënisht, do t'ja dij pér nder, por kurrikjt s'do t'i lutem, s'do të rrij duerkryq. Kryenaltë do të mundohem t'u baj ballë të gjitha punëve sado të vëشتira e të lodhëshme kjoftshin».

S'kaluan ditë dhe Palinën malësorët e panë në arat e konakut duke nxjerrë plehun nga hauri në arë. Dhe, menjëherë, filluan të qarkullojnë fjalët, sharjet. Ajo bënte veshin e shurdhër dhe sytë e

verbër, shikonte punën e saj, hallet e saj. Kishte edhe ndonjë burrë që e kritikoi sepse nuk u zuri besë shokëve e nuk pranoi ndihmën e tyre. Të tjerë thanë se ajo po thyente zakonet e maleve. Por Palina u a preu të gjithëve shkurt:

-- Unë due të rrisë fëmijët me djersën t'ime. Unë nuk pres ndihmë nga të tjerët. Ai që do të më ndihmojë le të vijë, por mos pritni t'i them kujt.

Kaloi viti i parë, i dyti dhe në të hyrë të vitit të tretë në fshat u fol se duheshin bërë përpjekje pér të hapur toka të reja. Edhe Palina i hyri kësaj pune. Ishte gjë e vështirë pér burrat e jo më pér gratë. Po ajo është sokoleshë. Bij trimash, e denjë pér të mbajtur jo vetëm furkën, por edhe pushkën e kazmën. U ra përqark gërxheve dhe shkëmbinjve. Gjeti disa të çara pér mes tyre dhe mendoi se me djersë e përpjekje diçka mund të dilte. Pa zhurmë e bujë, pa zotime e premtimë, i hyri punës. Punoi ditë e natë dhe nisi të hapë metrat e para të tokës së re. E kështu një pëllëmbë sot e një pëllëmbë nesër malësorja sokoleshë hapi tre dynymë tokë. Dhe menjëherë i mbolli, një pjesë me patate dhe tjetrën me misër. Ja, në këto toka të reja e njohëm Palinën, këtë grua trime nga e cila mund të mësosh shumë pér karakterin e saj të lartë, pér punën e saj këmbëngulëse, pér vendosmërinë e saj pér të kapërcyer vështirësitë dhe pér të zbatuar porositë e Partisë. Palina Prek Mehmeti duke siguruar bukën pér fëmijët dhe pér vete po bëhet shembull i mirë në malësinë e Shalës.

Mora pjesë edhe në mbledhjen e fshatit. Këtu foli edhe 75 vjeçari Nikë Pali:

— Besa burra këtu kemi le e jena rritë, por kso forca në veten tonë s'i kemi pasë as në rini. I kjofshim falë Partisë që po na mëson me urtësinë më të madhe si me punue e me jetue. Unë kisha 4 dynym tokë e me të, siç e dini, nuk si-gurojsha bukën veç për 6 muej. Jemi 18 vetë në shpi. U shtrue kjo puna e tokave të reja. Na dukej si e vështirë, por si thotë nji fjalë e urtë «Sheh rrushi rrushin e piqet». Vullneti burra çan edhe malet, thërmon edhe shkambinjt. Se si u çelën 5 dynym tokë as ne s'e muerrëm vesh. 4 dynym tokë më ranë në hise brez pas brezi, 5 dynym tokë çelëm me krahët tona. Besa burra u desh fjala e partisë që edhe ne për pak kohë të bajmë nji punë aqë të madhe sa nuk e banë breznit me radhë. I kjofshim falë Partisë.

Fliste plaku e sytë nuk ja ndante nuses së djalit të tij, që ishte struktur në një qoshe. Ai vazhdoi:

— Kemi punue boll, i madh edhe i vogël, por sa ka punue Katrina, asnji. Ajo si komuniste e dha shembullin në punët ma të vështira.

Tokat e reja të Nik Palit ishin shkurre dhe plot shkëmbinj. Çpyllëzimi, thyerja dhe heqja e tyre kërkonte punë të madhe. Por komunistja u kish propozuar grave të punonin edhe ato, bile të mos e turpëronin veten, të mos ndaheshin nga burrat e tyre. Dhe vetë kishte nisur e para nga puna.

Katrina punoi në pastrimin e borës, në heqjen e shkëmbinjve, në shkuljen e shkurreve dhe

të drizave, në bërjen e qilizmës. Katrinën do e gjenie në transportimin e dheut të mirë nga njëri vend në tjetrin, në shpërndarjen e plehut. Punonte e nuk ndihej kurrë, nuk thoshte asnjëherë se u lodha. Ja edhe në mbledhje, nuk flet. Malësorët kërkojnë të mësojnë nga eksperienca e Nikë Tomës dhe e Katrina Markut, por ajo thotë vetëm këto fjalë:

— Unë kam krye detyrën e komunistes në familjen time e asgja ma tepër.

\* \* \*

Shkuam edhe në fshatra të tjera vec Thethit, Lekajve, Lotëjve e Pecajve. Kudo e njëjta frymë mobilizimi. Malësorët që kanë vuajtur ndër shekuj për bukën e gojës, që për 22 vjet rrjesht muarrën bukë nga depot e shtetit, tani mendojnë ndryshe. Në ta është kriuar një sedër e shëndoshë që sei-cili ta prodhojë vetë bukën.

Dhe kudo që shkuam dëgjuam atë këngën e re:

— Dukagjinës ngjitu malit!

### H. BORICI

(Korrik-Gusht 1966)

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Hyrje .....	5
Biseda për bukën ( <b>I. Kadare</b> ) .....	9
Në rrëzët e Ivanit ( <b>S. Andoni</b> ) .....	13
Frutet e mendimit dhe të vrullit revolucionar <b>(B. Halili)</b> .....	20
Kooperativistët e Vrithit e shndërruan malin shkëmb- bor në tokë buke. ( <b>F. Cekodhima</b> ) .....	25
Toka e braktisur ( <b>V. Zallemi</b> ) .....	36
Në Spiten filloi kthesa kur politika u vu në plan të parë. ( <b>J. Toçka</b> ) .....	42
Një për të gjithë, të gjithë për një. ( <b>O. Allkja</b> ) .....	49
Tokat që nesër do të jepin bukë. ( <b>V. Koreshi</b> ) .....	58
Majë Dhëmblanit në furtunë. ( <b>M. Gjini</b> ) .....	63
Kapitulli i fundit i një historie ( <b>Xh. Abazi</b> ) .....	69
Rrugë të njohura dhe të panjohura ( <b>B. Halili</b> ) .....	76
Ujët e maleve rrjedh nëpër fusha. ( <b>J. Toçka</b> ) .....	82
Njeriu mposht natyrën ( <b>O. Allkja</b> ) .....	88
«Dukagjinës ngjitu malit» ( <b>H. Boriçi</b> ) .....	92